

NË KËTË NUMËR LEXONI



2 **Rrugëtimi drejt pavarësisë**

Demir Reshiti: Rrugëtimi drejt pavarësisë.....2-3

Milazim Krasniqi: Misioni civil evropian në Kosovë është legjitim..... 4

Besim R. Cengu: Rreziku nga identiteti "kosovar" ...5
Intevistë me Baki Svircën 6-7

Sead Ujkani: Kosova vendi me nivelin më të lartë të papunësisë në rajon 8

Avni Avdiu: Shqiptarët e Maqedonisë pas pavarësimit të Kosovës 9

Florije Ademi: Aty ku ka gjallëri e vullnet për jetë10-11

Gëzim Qerimi: Simbol i dijes, rezistencës dhe çlirimit të Kosovës 11

Dr. Mazllum Baraliu: Qeverisja e mirë, paqja dhe perspektiva në Kosovë12-13

Florentina Lata: "Trendi" i shkurorëzimeve trondit Kosovën 14-15

Emine A. Vezaj: Çfarë do të thotë të jesh i ri në Kosovë16

Mirsad Kuteli: Zinxhiri i një shoqërie të devotshme ...17

Demir Reshiti: Shqetësime për zhvillimet në Kosovë ...18-19

Gëzim Qerimi & Osman D. Gashi: Fotoreportazhi?... 20-21

Bujar Sejdiu: Shën Valentini misterioz 22

Arben Muhameti: Diplomacia e Detantës dhe ndikimi i saj në përfundimin e luftës së ftohtë.....23

Muhamed Jusufi-Kajolli: Shtrembërimi i historisë ...24-25

Muhamed Jusufi-Kajolli: Të fillojmë të shkruajmë hapur për çështjet që na preokupojnë26-27

Dr. Fadil Maloku: A mund të përkufizohet Globalizmi 28-29

Flamur Maloku: Vetmia në figurën e metaforës30-31
Poezi32

Berat Dakaj: Ministria e Kulturës, e parëndësishme...33

Genta Hoxha: Muzeu Etnologjik i Prishtinës letërnjoftim i trashëgimisë kulturore34-35

Dr. Ali Iljazi: Kreativiteti dhe inteligjenca emocionale...36-37

Artan Bejta & Iliriana Alloqi: Meningjiti-infeksion serioz38-39

Fjalëkryqi40



6 **Intervistë me Baki Svircën**



12 **Qeverisja e mirë, paqja...**




26 **Të fillojmë të shkruajmë hapur...**



37 **Kreativiteti anë inteligjenca...**

REDAKSIA E REVISTËS "PAQJA", TË GJITHË QYTETARËVE TË KOSOVËS UA URON PAVARËSINË E KOSOVËS!



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 15
19 Shkurt 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor gjuhësor
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Rrugëtimi drejt pavarësisë



Demir RESHITI

Përpjekjet e Kosovës për liri dhe krijimin e një shteti të pavarur kanë zgjatur gati një shekull. U deshtë të bëhen 96 vjet rrugë dhe të zhvillohen shumë luftëra, të vriten dhe të shpërngulen qindra mijëra njerëz, të burgosen mijëra të tjerë, të sakrifkohen gjenerata të tëra për të realizuar këtë qëllim.

Kjo rrugë e gjatë, me shumë sfida e mundime u kurorëzua më 17 shkurt, kur 109 deputetë të Kuvendit të Kosovës shpallën pavarësinë.

Në vazhdim po i përmendim në mënyrë kronologjike disa nga datat më të rëndësishme që i kanë paraprirë kësaj ngjarje të madhe:

Më 28 nëntor të viti 1912, delegatët e të gjitha trevave shqiptare, pas një rrugëtimi të gjatë, arritën në Vlorë dhe nën udhëheqjen e Ismail Qemalit, shpallën Shqipërinë shtet të pavarur dhe sovran. Mirëpo, Shqipëria e cila fillimisht nuk u njoh nga shtetet ballkanike dhe nga Rusia cariste, më vonë u copëtua në pesë pjesë.

Ndarja u zyrtarizua në Konferencën e Ambasadorëve në Londër që u mbajt në vitin 1913, e cila u mbajt menjëherë pas Luftës Ballkanike. Kosova sipas marrëveshjes së Londrës, mbeti nën administrim Serbisë, sikurse që mbetën nën administrimin e Malit të Zi dhe Greqisë, Çamëria, Fusha e Pollogut, Ohri, Struga, Dibra, Ulqinin, Tivari, Plava e Gucia.

Vetëm për tri vite (1912-1915), Serbia shpërnguli me dhunë nga Kosova rreth 60 mijë shqiptarë.

Të pakënaqur, shqiptarët filluan spontanisht kryengritjen, fillimisht nën drejtim të Bajram Currit e Hasan Prishtinës, më vonë edhe nën drejtim të Azem Galicës. Po ashtu, Kosova u bë arenë luftimesh edhe në luftën e Parë Botërore e gjithashtu vazhduan pandalshëm përpjekjet për ribashkim me Shqipërinë.

Pas pushtimit serb (Serbisë së parë), Kosova në vitin 1916 pushtohet nga

Bullgaria dhe Austro-Hungaria.

Dy vjet më vonë, shqiptarët organizuan kryengritje dhe brenda një periudhe jo të gjatë e çliruan Kosovën, e cila pas pak sërish pushtohet nga serbët. Dhe nga mesi i viteve '20 deri në luftën e Dytë Botërore vazhduan luftime kaçake kundër Serbisë, por pa ndonjë sukses.

Serbia filloi të implementojë në Kosovë reformat agrare. Gjithë atë pasuri që fitonin shqiptarët e Kosovës brenda një viti ishin të obliguara t'ia dorëzjnë mbretërisë serbe. Po ashtu, Serbia filloi shpronësimin e tokave të shqiptarëve duke i kthyer ato për kolonë serbë.

Vetëm në mes dy luftërave (1918-1941) Mbretëria Serbe solli në Kosovë mbi 15 mijë familje kolonësh serbë me rreth 75 mijë banorë. Ky kolonizim ndryshoi edhe strukturën etnike në Kosovë. Në vitin 1912 shqiptarët përbënin gati 95 për qind të popullsisë së Kosovës, ndërsa në vitin 1941 kjo përqindje ra në 70 për qind.

Rreth 500 mijë shqiptarë të Kosovës bëhen skllëvër të rinj në tokat e tyre. Ndërsa edhe 250 mijë të tjerë detyrohen të shpërngulen për në Turqi dhe Shqipëri. Serbia me këtë rast aplikoi një projekt të mëhershëm të njohur si "Nacertania" e Nikola Garasaninit për spastrimin e Kosovës nga shqiptarët.

Lufta e Dytë Botërore (1941-1945) Kosovën dhe viset tjera shqiptare i gjeti nën pushtimin sllav. Prandaj, invadimi i fashizmit dhe nazizmit fillimisht u duk si shpresë për t'i ikur zgjedhës serbe dhe si alternativë për të bashkuar Kosovën me Shqipëri.

Më 14 shtator 1943 në Prizren u mbajt Lidhja e Dytë e Prizrenit me në krye Bedri Pejani. U mor vendim që nën administrimin Italo-Gjerman të luftohet për Shqipërinë etnike. Përpjekja dështoi, sikurse dështoi edhe përpjekja tjetër e Krahut Antifashistë, pas një konference që mbajtën në Bujan të Tropojës. Kjo mbledhje u quajt si Konferenca e Bujanit ku u mor vendim që Kosova dhe viset tjera shqiptare të bashkoheshin me Shqipërinë.

Pas kapitullimit të Gjermanisë, Kosova sërish mbeti pjesë e Jugosllavisë, si krahinë autonome nën Serbi. Sipas

statistikave, nga viti 1945-1948 u vranë mijëra shqiptarë, ndërkohë që krimet më të rënda u bënë në Karadak dhe Drenicë.

Në vitet '50-ta Serbia aplikoi metodën e re për shpërnguljen e shqiptarëve. Ajo fillimisht i detyroi shqiptarët që të deklarohen turq, ndërsa më vonë filloi edhe aksionin për kërkimin e armëve e njohur si "periudha e Rankoviqit". Nga represioni dhe dhuna vetëm për dy vjet për Turqi u larguan 74 mijë shqiptarë.

Dhuna e Serbisë filloi t'i vejë në shënjestër të gjithë intelektualët shqiptarë. Vetëm në vitet '50 u burgosën rreth 500 veta të cilët përfunduan në burgun famëkeq Goli Otok.

Në vitin 1968, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, u organizuan demonstrata në të gjitha rajonet shqiptare. U kërkua ndryshimi i kushtetutës, flamuri kombëtar dhe universiteti.

Më 18 nëntor 1969 Kuvendi Krahi i Kosovës miratoi ligjin për Universitetin e Prishtinës. U lejua edhe përdorimi i flamurit, ndërsa në vitin 1974 u ndryshua edhe Kushtetua e Jugosllavisë, ndërsa Kosova u bë element konstituiv i Federatës Jugosllave.

Studentët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës, më 11 mars 1981 organizuan demonstrata gjithë-popullore me kërkesë për Kosovën Republikë, të cilat u shuan me gjak.

Nga viti 1981 deri në vitin 1998 nëpër organet e policisë kaluan rreth 700 mijë shqiptarë

Nga viti 1981 deri në vitet '90, Kosova u shndërrua në një kamp të madh të ushtrisë dhe policisë jugosllave. Këto të fundit u munduan të shuajnë euforinë e shqiptarëve, të cilët edhe në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 vazhduan pareshtur protesta kundër regjimit të Serbisë dhe Jugosllavisë. Në këto protesta nga policia u vranë rreth 200 protestues.

Regjimi i Serbisë nën drejtimin e kriminelit Slobodan Milosheviq, në fillim të dekadës së kaluar, mbylli universitetin, të përditshmen Rilindja, Radio-

televizionin e Prishtinës dhe largoi nga puna të gjithë shqiptarët nga të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore.

Nëpër organet e policisë, nga viti 1981 deri në vitin 1998 kaluan rreth 700 mijë shqiptarë: 10 mijë veta u dënuan për kundërvajtje, ndërsa rreth 4 mijë morën dënim mesatar prej 7.1 vjet burg. Në këtë periudhë gjithashtu u dënuan rreth 1.347 ushtarë shqiptarë në APJ ndërsa 67 u vranë në kazerma.

Gjatë kësaj kohe emigruan në shtetet perëndimore rreth 500 mijë shqiptarë.

Muaji shkurt i vitit 1989 u karakterizua me grevën e minatorëve të kompleksit Trepça, në mbrojtje të pozitës kushtetuese të Kosovës. Greva e minatorëve besohet se lëkundti themelet e ish-Jugosllavisë.

Më 23 mars 1989, në Kuvendin e Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, ndryshohet Kushtetuta e vitit 1974, me çka suprimohet autonomia e Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën si një pjesë përbërëse të Serbisë. Suprimimi i autonomisë pasoi pushtimin e Kosovës me mijëra policë e ushtarë serbë, duke e vënë popullatën shumicë nën masa represive dhe aparteidi.

Më 2 korrik të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës shpalli deklaratën kushtetuese që e definonte Kosovën Republikë. Deklarata e pavarësisë u pasua edhe me nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 7 shtator të vitit 1990 në Kaçanik.

Me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, Kosova organizoi edhe referendumin për pavarësi e sovranitet, të mbajtur në shtatorin e vitit 1991. Nga ky moment, në Kosovë instalohet sistemi i organizimit paralel, që pasoi zgjedhjet e mbajtura jashtë sistemit juridik serb, në të cilat Rugova zgjidhet president i Republikës së Kosovës dhe formon qeverinë në ekzil, të udhëhequr nga kryeministri Bujar Bukoshi. Por, kjo Republikë dhe kjo qeveri nuk gëzuan njohje ndërkombëtare, sado që në Kosovë kishin një përkrahje masive.

Në vitin 1997, shqiptarët vendosën t'i kundërpërgjigjen Serbisë dhe regjimit të dhunshëm të saj me mjete luftarake.

Më 1 tetor të vitit 1997, Lëvizja Stu-

dentore organizon një protestë masive, e cila i dha një dimension të ri politik zhvillimeve në Kosovë.

Më 28 nëntor 1997 në Llaushë të Skenderajt doli në skenë për të parën herë Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) e cila u pa si shpresa fundit për të dalë nga zgjedha e Serbisë.

Më 5 mars 1998 në Prekaz të Drenicës, Adem Jashari dhe Jasharët legjendarë iu kundërpërgjigjen hapur forcave serbe. Në këtë betejë që u perceptua si kthesa e madhe për shqiptarët, u vranë 50 anëtarë të familjes Jashari.

Vrasjet dhe masakrat e shumta kulmojnë më 15 janar të vitit 1999, kur forcat serbe ekzekutojnë 45 civilë shqiptarë në Reçak. Ish-shefi i Misionit Mbikëqyrës të OSBE-së në Kosovë, William Volker, doli botërisht dhe e tha se ajo ishte një masakër. Nga ky moment, Uashingtoni kërkoi nga NATO-ja dhe evropianët të



përgatiten për organizimin e një konference paqësore për Kosovën. Dhe ajo ndodhi, në Rambuje, afër Parisit.

Lufta e UÇK-së e shtyri bashkësinë ndërkombëtare që në Rambuje të Francës të organizojnë një konference për paqe.

Forcat e kombinuara-policore-ushtarake dhe paramilitare serbe, vranë rreth 12 mijë civilë shqiptarë, shumica gra, fëmijë e pleq, dhe dogjën rreth 200 mijë shtëpi. Po ashtu Serbia depërtoi jashtë Kosovës rreth një milion shqiptarë.

Dhuna që aplikoi Milosheviqi detyroi Aleancën e NATO-s që të sulmojë nga ajri forcat serbe.

Nga 24 marsi deri më 10, përkatesisht 12 qershor të vitit 1999, fillon historia e re e Kosovës. UÇK-ja nga toka dhe NATO nga ajri, më 12 qershor 1999 detyruan Milosheviqin të nënshkruajë

kapitullimin. Ndërkohë që Këshilli i Sigurimit, në bazë të një kompromisi ndërmjet perëndimit e Ruisë, miraton Rezolutën 1244, me të cilën vendoset Misioni administrues i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Nën administrimin ndërkombëtar, në Kosovë mbahen tri palë zgjedhje në të dyja nivelet. Pas zgjedhjeve të 17 nëntorit të vitit 2001, më 4 mars të vitit 2002, Kosova formon qeverinë e parë dhe zgjedh presidentin dhe kryeministrin.

Më 28 shtator të vitit 2005, me kërkesën e ndërkombëtarëve Kuvendi i Kosovës formoi Ekipin Negociator për statusin.

I dërguari i posaçëm i OKB-së në bisedime, Martti Ahtisaari, propozon një plan gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, duke rekomanduar pavarësinë e mbikëqyrtur për Kosovën, me prani civile e ushtarake ndërkombëtare. Prishtina e pranoi, ndërsa Beogradi e refuzoi këtë plan.

Përpjekjet ndërkombëtare nuk rezultojnë as me zëvendësimin e Rezolutës 1244 për t'i hapur rrugën pavarësisë së Kosovës përmes Kombeve të Bashkuara, për shkak se Rusia kërcënoi me veto në Këshillin e Sigurimit. Por, pas një interpretimi nga ekspertët evropianë, doli se Rezoluta 1244 ka bazë

juridike për shpalljen e pavarësisë dhe largimin e misionit të Kombeve të Bashkuara dhe vendosjen e një misioni civil të Bashkimit Evropian.

I gjithë procesi u dakordua me Prishtinën dhe u miratua shpallja e koordinuar e pavarësisë ndërmjet Uashingtonit, Brukselit dhe Prishtinës, sipas planit të Ahtisaarit. Kështu, Bashkimi Evropian miraton dërgimin e misionit civil në Kosovë për të mbikëqyrtur zbatimin e pakos së Ahtisaarit dhe për të siguruar sundimin e ligjit në shtetin më të ri të familjes evropiane.

Pas këtij hapi, më 17 shkurt të vitit 2008, 109 deputetë të kuvendit të Kosovës shpallin pavarësinë dhe miratojnë flamurin e shtetit të Kosovës. Flamuri ka fushën e kaltër, me hartën e Kosovës në mes, dhe gjashtë yje të bardhë mbi hartën me ngjyrë ari. ■

Ana tjetër e medaljes

Misioni civil evropian në Kosovë është legjitim



Milazim KRASNIQI

Qëndrimi më i ri i diplomacisë ruse, sipas të cilit misioni civil i Bashkimit Evropian duhet të ketë miratimin e Këshillit të Sigurimit dhe pajtimin e Beogradit (krahas miratimit të Prishtinës), tregon se ajo diplomaci udhëhiqet nga një mendësi jorealiste dhe jologjike. Në fakt, dihet se negociatat ndërmjet Prishtinës e Beogradit, të drejtuara për gati dy vjet nga presidenti Marti Ahtisari, nuk dhanë asnjë rezultat. As negociatat shtesë, të drejtuara nga treshja Ishinger- Vizner-Harçenko, nuk sollën asnjë rezultat. Në negociatat shtesë, Beogradi zyrtar e refuzoi edhe Traktatin e Miqësisë, të cilin e afroi me shumë zemërgjerësi Prishtina zyrtare. Refuzimi i njëanshëm i një oferte të këtillë, e cila do të krijonte premisat e një pajtimi në të ardhmen, e zbuloi prirjen inatçore dhe armiqësore të qeverisë serbe ndaj Kosovës.

Pas bllokimit të negociatave nga ana e qeverisë serbe, bllokimin tjetër e bëri vetë qeveria ruse, e cila në Këshillin e Sigurimit nuk lejoi që të procedohej një rezolutë e re për Kosovën. Me rastin e bllokimit të rezolutës së re, Rusia nuk mori para sysh qëndrimin e të dyja palëve, por vetëm interesin e njëjës palë, pra të Serbisë.

Në të vërtetë, pas refuzimit të Traktatit të Miqësisë nga ana e Serbisë, as që ka gjasa të merren parasysh të dyja qëndrimet, meqë ato nuk e kanë një terren të përbashkët të përkushtimit ndaj të ardhmes. Refuzimi i ofertës së tillë është bërë për ta mbajtur çështjen të bllokuar. Nga Beogradi dhe nga Moska është llogaritur se bllokimi do të sillte reaksionin e ashpër të shqiptarëve dhe konfrontimin e tyre me komunitetin ndërkombëtar. Këtë

gjë e ka motivuar edhe hezitimi i disa shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat kanë interesa konkrete ose vetëm sentimente ndaj Serbisë. Në këtë mes shtete më problematike janë treguar Rumania, Sllovakia, Greqia dhe Qiproja. Por, fuqia e tyre nuk ka qenë e mjaftueshme për ta miratuar bllokimin e procesit.

Rusia po përpiket ta radikalizojë qëndrimin e vet antikosovar dhe antiperëndimor. Lancimi i tezës së gjoja misioni civil i Bashkimit Evropian nuk do të jetë legjitim, është shumë jologjik, pasi që në kuadër të UNMIK-ut, Bashkimi Evropian tash e tetë vjet është prezent në Kosovë me një mision të madh civil. Shtylla e katërt e UNMIK-ut, ka qenë ekskluzivisht në duart e Bashkimit Evropian, që nga fillimi i misionit të OKB- së në Kosovë. Transformimi i misionit nga ekonomia në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë, i rekomanduar nga Marti Ahtisari, është një transformim i përshtatur me nevojat e Kosovës. Por, prezenca e Bashkimit Evropian mbetet plotësisht legjitime, si me rezolutën 1244 si me planin e Marti Ahtisarit.

Nga ana tjetër, diplomati rus, Aleksander Harçenko, para disa ditësh u

kërcënuar me mundësinë e ndarjes së Kosovës, në rast të shpalljes së pavarësisë së saj. Kjo deklaratë jologjike e zbulon fytyrën e vërtetë të diplomacisë dhe të politikës luftënxitëse të Rusisë putiniane. Në një rën anë flitet për “ruajtjen e rendit ndërkombëtar”, ndërsa në anën tjetër lancohen kërcënime për copëtimin e një vendi që është nën mbrojtje ndërkombëtare.

I gjendur nën trysinë e komprometit të taktikave të tij, ministri i jashtëm i Rusisë, Sergej Lavrov, para do kohësh u ankua se Perëndimi nuk po e kuptuaka si duhet Rusinë. Ankesa e tij poashtu është jologjike, sepse nuk mund të mirëkuptohet nga bota demokratike një shtet që dëshiron të rindezë luftërat e sapofashitura në rajonin e trazuar të Ballkanit. Por, kjo është një mendësi e vjetër ruse, e ndezjes së luftërave, (si në Kore a në Vietnam), për ta mbajtur pastaj të gozhduar Perëndimin në ato luftëra. Mirëpo, tash “moskuptimi” për Rusinë vjen nga një fakt tjetër: ajo është humbëse e luftës së ftohtë dhe i duhet t’i vuajë gjithandej pasojat e humbjes. Pra, edhe në Ballkan. ■



Rreziku nga identiteti "kosovar"

Është jetike për popullin shqiptar, që në këto çaste vendimtare të historisë tonë, ta administrojmë me mençuri pavarësinë e fituar, këtë moment të shenjtë historik të shumëkërkuar, por në të njëjtën kohë për shkak të saj të mos bëhemi dy popuj shqiptarë...



Besim R. CENGU

Presidenti shqiptar Bamir Topi, një ditë para se të realizojë vizitën "turistike" në vendin kandidat për shtet të ri që do të quhet Kosov(o)ë, në Bruksel u gjend para një pyetje të një deputeti serb. Në esence pyetja kishte të bënte me qëndrimin zyrtar të Shqipërisë kundrejt Kosovës dhe kosovarëve pas definimit të statusit. Deputeti serb synonte që Presidenti me gojën e vet të ndante qartë Kosovarët me Shqiptarët. Dhe këtë e bëri presidenti Shqiptar Bamir Topi, për të qenë oportun. Në vend që të bënte të qartë se ka vetëm një çështje shqiptare në Ballkan, një popull shqiptar që frymon në këtë gadishull, por që për shkak të rrethanave populli shqiptar sot ka pranuar kompromisin e madh, që është pavarësia e kontrolluar, ai për tu ndjerë mire gjatë sqarimit thotë pak a shumë se Shqipëria e Kosova janë dy vende të ndryshme që synojnë të inkuadrohen secila të pavarura në rrugën e vet në Evropë.

Meraku serb dhe rezerva shqiptare

Në fakt kjo sjellje nuk do të thotë që për hir të një qëndrimi gjoja të moderuar, të marrësh nëpër këmbë realitetin historik. Presidenti duhej të shprehej qartë se padrejtësitë historike kanë ndarë popullin tonë në mes, se Serbia e atij deputeti që interesohej, me programe shoviniste e strategji gjenocidiale, ka sunduar deri në vitin 1999 gjysmën e kombit shqiptar, dhe se vetë Evropa e asaj kohe duke qëndruar në krah të shtetit serb, qe shkaktarja e kësaj tragjedie dhe që sot, po tenton të korrigjojë këtë gabim. Këtë nuk e tha presidenti, ndoshta edhe për shkak, se ai sipas Mero Bazës "nuk e

njuh mirë realitetin në Kosovë" (merre me mend, është fjala për presidenti shqiptar), prandaj ai një ditë më vonë gjatë vizitës së tij "turistike" në Kosovë "shkeli në fushë të minuar" për shkak të kësaj mosnjohje. Prandaj kjo vizitë nuk pati asnjë ide, asnjë vizion të ri, e për më tepër, jo shumë gjurmë e jehonë të mëpastajme që do të ndikonte në dhënien e një impulsi të ri të ecurisë së ngjarjeve. Presidenti Bamir Topi, sipas të gjitha gjasave, nuk erdhi në Kosovë për t'i ndihmuar ngjarjes më të madhe kombëtare, pavarësisë, porse, përmes këtij evenimenti, u përpoq të ndihmojë veten që të "promovohej" si Kryetari i Shqipërisë, (sipas shumë kompromismëdhenjëve, "të një vendi fqinj që ka identitetin e vet të ndryshëm me Kosovën e kosovarët, pavarësinë e vet, ecurinë e veçantë drejt integritetit në Evropë, por që do të jetë ndër të parët që do të njohë pavarësinë).

Në kemi të drejtë të jemi skeptikë në vizitën "turistike" të presidentit Bamir Topi në Kosovë, kur veç gjithë këtyre ai luan edhe rol përjashtues të asaj inteligjencie e cila nuk është me mendimet e tij. Se ai përjashtoi emrin e akademikut Rexhep Qosja (dhe shumë të tjerëve) në fjalën e tij në ceremonialin e marrjes së çmimit "Honoris Causa" në Universitetin e Prishtinës, kjo nuk është gjë e vogël, por është një gafë jo vetëm politike. Topi me këtë tregoi se nuk po mundet të ngrihet më lart se çështje në realitet; nënkryetar i partisë demokratike. Ndryshe nuk do t'i lejonte vetes dhe postit të lartë që mban veprime të tilla...

Popujt sllavë dhe popu(jt)li shqiptar(ë)

E kam cekur krejt shkarazi në një shkrim të mëparshëm se edhe pse rrethanat e popullit shqiptar në Ballkan, gjatë historisë kanë qenë gjithnjë të vështira e krejt të papërshtatshme, asnjëherë nuk është arritur që populli shqiptar të "copëzohet" në popuj shq-

iptarë, siç ndodhi me sllavët. Ai ruajti konstitucionin shpirtëror, gjuhën, kulturën e traditën e vet. Sllavët, edhe pse erdhën në Ballkan tepër vonë, copëtuan shpirtin e tyre në disa pjesë, edhe ky për shkak të rrethanave.

Mirëpo, tash kur populli shqiptar po kalon nga një fazë në një tjetër, tepër të rëndësishme e jetike, dmth nga faza e pasluftës në atë të pavarësisë, ka shumë të ngjarë të ketë një prirje që ne i druemi: prirja e tendenca për ecjen drejt kristalizimit të një identiteti të ri, i ashtuquajtur identiteti kosovar. T'i ndihmosh kësaj prirje, do të thotë për herë të parë në historinë shqiptare shumë shpejt të përdoret togfjalëshi "popujt shqiptarë" në Ballkan. Kjo nënkupton që secili të ketë rrugën e vet, kulturën, gjuhën, mentalitetin e vet(!).

Është jetike për popullin shqiptar, që në këto çaste vendimtare të historisë tonë, ta administrojmë me mençuri pavarësinë e fituar, këtë moment të shenjtë historik të shumëkërkuar, por në të njëjtën kohë për shkak të saj të mos bëhemi dy popuj shqiptarë se kështu përmbushim synimin e fqinjëve por edhe më tej. Nuk mund të integrohesh në Evropë pa integruar vetveten. Duke nënkuptuar edhe situatën pas pavarësisë si fazë, siç edhe është në realitet, sigurisht që historia e bërjes tonë vazhdon përsëri. Qëndrimi i një populli në "fazë", që do të thotë në tranzicion, është e rrezikshme. Pak ditë para se të vdiste At Zef Pllumbi në një intervistë që shprehur "se populli shqiptar është në tranzicion që nga viti 1912". Asnjë popull nuk ka përjetuar tranzicion kaq të gjatë. Tani ne së bashku kësaj faze duhet t'i japim fund. Sot më shumë se kurrë është në dorën tonë. Pavarësia (të cilën duhet ta administrojmë) është një hap i madh për të dalë nga kjo gjendje. Hapa të tjerë na presin në të ardhmen, që mund të realizohen jo si popuj shqiptarë, por si popull shqiptar. ■

Intervistë me drejtorin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, Baki Svirca

Politizimi rrezikon trashëgiminë

- 426 monumente të kategorive të ndryshme janë nën mbrojtje institucionale;
- Restaurimi i Xhamisë së Llapit në fazën përfundimtare;
- Trashëgimia kulturore dallon nga trashëgimia fetare;
- Në Kosovë janë përhapur “ethet e arit”;

Intervistoi: Demir Reshiti

Drejtori i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, Baki Svirca, në intervistën ekskluzive për revistën “Paqja”, shpreh shqetësimin e tij për gjendjen alarmuese në të cilën gjenden sot monumentet e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Mosrespektimi i prioriteteve në fushën e trashëgimisë, politizimi i trashëgimisë, dhe mungesa e buxhetit, janë problemet serioze me të cilat po ballafaqohet trashëgimia në Kosovë, thekson bashkëbiseduesi ynë.

Sipas tij, çështjet e trashëgimisë kulturore dhe fetare, të cilat janë përfshirë në aneksin e pestë të dokumentit të Ahtisaarit për Kosovën, nuk janë trajtuar drejt, sepse pavarësisht që trashëgimia fetare mund të jetë edhe trashëgimi kulturore, këto të dyja janë koncepte të ndryshme dhe të ndara.

Svirca në këtë intervistë flet edhe për bashkëpunimin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore me institutet simotra të rajonit, punimet që po zhvillohen në restaurimin e Xhamisë së Llapit në Prishtinë, përhapjen e të ashtuquajturave “ethet e arit”, në Kosovë, etj.

426 monumente të kategorive të ndryshme janë nën mbrojtje institucionale

PAQJA: Çfarë trashëgimie kulturore disponon Kosova?

Svirca: Kosova, ka një trashëgimi kulturore, e cila për nga kategoritë e saja na paraqitet si sakrale, profane dhe utilitare, ndërsa për nga lloji ajo nuk është përjashtuese nga areali kulturor shqiptar dhe ballkanas. Në Kosovë nën mbrojtje kemi 426 monumente të kategorive të ndryshme, numër ky që është listëzuar nga vitet e para të pasluftës së dytë botërore. Po ashtu



Baki Svirca ka lindur më 1973 në Prishtinë, ku i ka kryer edhe studimet për Histori, si bursist i fondacionit SOROS. Pas lufte ka punuar në disa organizata. Ka qenë Këshilltar për OJQ-të në strukturat e përbashkëta administrative, të krijuara nga UNMIK-u dhe partitë politike. Nga viti 2002-2004, ka punuar si Drejtor në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, prej nga kalon në detyrën e drejtorit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore. Ka ndjekur shumë trajnime specialistike për menaxhim në disa vende të botës, si: Austri, Finlandë, Amerikë etj.

kemi edhe një numër të objekteve dhe tërësive kulturore që duhet valorizuar për ti futur nën mbrojtje. Monumentet dhe tërësitë kulturore të Kosovës janë një pasuri e madhe e cila duhet promovuar dhe shfrytëzuar në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Shikuar nga prizmi kohorë, trashëgimia kulturore e Kosovës ka kaluar nëpër të gjitha proceset socio-politike, nëpër të cilat ka kaluar vetë shoqëria e Kosovës. Faktet që kemi në posedim, tregojnë se në këto troje trashëgimia në shumicën e rasteve është konsideruar si element shumë i fortë, në duart e sistemeve politike, përmes së cilës është tentuar të sajohen të „vërtetat“ historike dhe politike.

PAQJA: Si paraqitet gjendja e monumenteve të trashëgimisë kulturo-historike në Kosovë?

Svirca: Gjendja e trashëgimisë në përgjithësi është e rëndë, por në veçanti është për t'u theksuar, se është e rëndë gjendja e atyre monumenteve, të cilat janë jofunksionale. Të rrezikuara janë edhe monumentet nëpër qendra të qyteteve që janë posaçërisht të atakuara nga apetitet për të shfrytëzuar lokacionet e tyre dhe përreth tyre për aktivitetet komerciale.

Përveç mungesës së fondeve dhe organizmit kemi edhe mungesën e vetëdijes së qytetarit tonë për rëndësinë që paraqet monumenti për shoqërinë. Po ashtu edhe

gjendja e përgjithshme ekonomike dhe sociale e shfrytëzuesve apo pronarëve të monumenteve doemos ndikon në gjendjen e monumenteve. Si do që të jetë, më asgjë nuk duhet arsyetuar gjendjen e monumenteve në Kosovë.

PAQJA: A keni bashkëpunim me institutet simotra në rajon dhe më gjerë?

Svirca: Ne kemi bashkëpunim me disa Institucione jashtë Kosove. Përveç me Institutin e Shqipërisë, kemi bashkëpunim edhe me atë Slloven. Ne jemi duke u munduar që të krijojmë një rrjet bashkëpunimi me shumë institucione të shumë vendeve, por duhet pasur parasysh që bashkëpunimi i mirëfilltë krijohet mbi disa baza, si ajo e publikimeve, hulumtimeve, studimeve, shkëmbimit të kuadrove etj, të cilat kërkojnë mjete për realizimin e tyre.

Po ashtu edhe vetë struktura e organizmit institucional në Kosovë paraqet një pengesë në vete për realizimin e bashkëpunimit të nivelit qendror.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi mund ta përmendi nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim me Qendrën Nacionale për Konservim të Maqedonisë. Ky bashkëpunim është i një rëndësie të veçantë si për Kosovën ashtu edhe për Maqedoninë, sepse është bashkëpunimi i parë rajonal në fushën e trashëgimisë kulturore dhe monumenteve historike dhe mund të pasohet edhe me marrëveshje tjera.

Restaurimi i Xhamisë së Llapit në fazën përfundimtare

PAQJA: *Kohë më parë ka filluar restaurimi i Xhamisë së Llapit në Prishtinë. Deri ku kanë arritur punimet, dhe cili është roli i Institutit që drejtoni ju, në këtë projekt?*

Svirca: Bashkësia Islame e Kosovës në angazhim për t'iu qasur objekteve Islame të cilat kanë vlera të veçanta arkitektonike, kërkoi nga Instituti ynë që të fillojë hartimin e projektit për konservimin dhe restaurimin e objektit të Xhamisë së Llapit. Duke qenë se mandati ynë është studimi, mbrojtja dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore, angazhuam ekipin i cili hartoi projektin e studimit, konservimit dhe restaurimit të kësaj xhamie.

Mjetet për realizimin e këtij projekti i ka dhuruar fondacioni i z. Behxhet Pacolli ndërsa zbatimin e punimeve në xhami është duke i kryer Kompania "Mabetex", nën mbikëqyrjen e tonë.

Tani punët janë në fazën e trajtimit të mbulesës dhe të fasadave të objektit të cilat janë punë e koordinuar ndërmjet mjeshtrëve tradicional dhe kompanisë "Mabetex", gjithnjë nën mbikëqyrjen e ekspertit të Institutit.

Sipas dinamikës aktuale në presim që punimet të kryhen diku rreth tremujorit të tretë të këtij viti.

Plani ynë është që të trajtohet i tërë kompleksi i xhamisë, kështu që tani jemi në diskutime me Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të hartuar edhe

një projekt i cili do të rehabilitonte tërë kompleksin, ose më mirë të themi pjesën tjetër të mbetur ku përfshihen objektet ndihmëse të xhamisë.

Trashëgimia kulturore dallon nga trashëgimia fetare

PAQJA: *Si e vlerësoni trajtimin e çështjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare, të përfshira në aneksin e pestë të dokumentit të Ahtisaarit për Kosovën?*

Svirca: Çështjet e ashtuquajtura të trashëgimisë kulturore dhe fetare, të cilat janë përfshirë në aneksin e pestë të dokumentit të Ahtisaarit për Kosovën, nuk janë trajtuar drejt, sepse pavarësisht që trashëgimia fetare mund të jetë edhe trashëgimi kulturore, këto të dyja janë koncepte të ndryshme dhe të ndara. Në këtë kontekst, trajtimi i kësaj çështjeje në dokumentin e Ahtisaarit, nuk është i qartë dhe profesional.

Mendoj që në këtë dokument, do të duhej qartësisht të ndahej koncepti i trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë fetare. Trashëgimia kulturore është trashëgimi e cila nuk njihet bazë identiteti ose nuk duhet të trajtohet në bazë të etnikumeve ose bartësve të kulturave, sepse ato, tek e fundit, përcaktohen përmes hulumtimeve të thella profesionale dhe shkencore. Në këtë kontekst, do të thotë, çdo gjë që është trajtuar si trashëgimi ortodokse, është marrë automatikisht edhe si trashëgimi kulturore, që vërtet është për t'u diskutuar dhe është për t'u perceptuar në mënyra të ndryshme.

Mungesa e përkufizimit të saktë të trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë fetare atakon vlerat e tyre, sepse jo rrallë në dokumentin e Ahtisaarit, monumenteve fetare ose atyre kulturore u vihet parashpresa ose prapashpresa në bazë të etnikumit.

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura në dokumentin e Ahtisaarit, nuk janë zbatuar kriteret që zbatohen gjithkund në botë, në bazë të konventave ndërkombëtare për përcaktimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe menaxhimin e kësaj trashëgimie. Shembuj konkretë, janë dhënia e kompetencave për menaxhimin e këtyre zonave.

PAQJA: *Si trajtohen në dokumentin e Ahtisaarit objektet kulturore ose fetare, të cilat janë të futura në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s?*

Svirca: Objektet kulturore ose fetare, të cilat janë të futura në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s, paraqesin problem në vetë, sepse për menaxhimin e këtyre zonave, ekzistojnë kriteret të parapërcaktuara nga kjo organizatë. Sipas këtyre kriterëve, autoritetet qendrore institucionale të cilat kanë përfaqësim në këtë mekanizëm ndërkombëtar, siç është UNESCO, janë përgjegjëse për t'u kujdesur për këto trashëgimi, që janë të licencuara në listën e trashëgimisë botërore. Tash shtrohet pyetja tepër logjike, se kush do të japë këtë llogari në rastin, për shembull, të Manastirit të Graçanicës ose në rastin e Manastirit të Deçanit etj? Institucionet qendrore, që përfaqësohen në këto mekanizma, apo institucionet lokale, siç janë komunat e reja apo komunat ekzistuese? Mendoj se ky është 'non-sens' i llojit të vet, që duhet të shqyrtohet nga aspekti i grupeve të larta të nivelit politik dhe institucional. Duke u bazuar në kriteret ndërkombëtare rreth trashëgimisë kulturore, mund të thuhet se trajtimi i kësaj çështjeje në dokumentin e Ahtisaarit, përmban mjaft paradokse dhe se ato duhen sqaruar. Mendoj që është një punë jashtëzakonisht e vështirë, që duhet t'iu qasemi në kuptimin multidiciplinar, për arsye të veçantë, se vetë krijimi apo shkrimi i këtij dokumenti, për mendimin tim personal, është më shumë politik sesa profesional, dhe nuk kontribuon, ashtu siç thuhet, në ruajtjen e këtyre vlerave. ■

Në Kosovë janë përhapur "ethet e arit"

Kohë më parë dy punëtorë të administratës së UNMIK-ut, një prej tyre i huaj dhe një lokal, të pajisur me një detektor metali dhe me një lopatë janë zënë duke "gjuajtur" ari në kalanë e Novobërdës.

Këta piratë të shekullit XXI ishin të pajisur me një detektor metali dhe me një lopatë, e ishin vënë në kërkim të qypit të artë. Gjurmët që ata kanë lënë mund të vërehen gjithandej kalasë së Novobërdës. Kalaja e Novobërdës është një nga rastet e shumta të trashëgimisë kulturore të Kosovës që bëhet pre e "gjuajtësve" të arit. Specialistët shumë herë kanë shprehur shqetësimin për këtë trashëgimi.

"Të gjitha dobësitë në ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore i shfrytëzojnë hulumtuesit ilegalë. Në Kosovë janë përhapur të ashtuquajturat "ethet e arit" dhe prandaj kemi këto lloj dëmtimesh. Këto hulumtime janë vetëm një prej dëmtimeve që na shkaktohen në trashëgimi, sepse edhe vizitat joformale të paautorizuara, të pakoordinuara, të pamenaxhuara, edhe ato shkaktojnë dëmtime në trashëgimi. P.sh. në këtë kala kemi shumë dëmtime, pasi ka shumë vizitorë që ngjiten mureve të kalasë. Gurët janë shumë të ndjeshëm për shkak të kohës dhe ato në çdo moment mund të bien", -ka theksuar Baki Svirca

Kosova vendi me nivelin më të lartë të papunësisë në rajon

Mosha e re e popullsisë është një nga indikatorët i cila ka bërë që numri i të papunëve përkatësisht numri i punëkërkuësve të rinj në tregun e punës të rritet nga viti në vit, në këtë kontekst shtohet edhe trysnia mbi tregun e punës

Sead UJKANI

Problemi i papunësisë sot shfaqet si problem global me të cilin ballafaqohen edhe shtetet në zhvillim. Në këtë kontekst ky problem nuk mbeti pa e prekur edhe vendin tonë, duke u identifikuar kështu edhe ndër problemet kryesore me të cilin është karakterizuar ekonomia e Kosovës, në veçanti dhe shoqëria e saj në përgjithësi.

Papunësia paraqet një problem serioz, dimensionet e së cilës shtrihen në tri aspekte, në aspektin social, ekonomik dhe atë politik, dhe dita-ditës në Kosovë po shënon një trend rritjeje.

Sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosova paraqet vendin me nivelin më të lartë të papunësisë shikuar në raport me vendet në rajon, ndërsa krahasuar me vlerën mesatare të papunësisë në BE, papunësia e Kosovës është rreth 4,5 herë më e lartë.

Duke shikuar Raportin e performancës të punës dhe punësimit në vendin tonë të publikuar së fundmi nga MMPS vërejmë se numri i përgjithshëm i personave të regjistruar si të papunë gjatë periudhës 06/2007 ishte 332775,

vlerë kjo e cila përfaqëson një shkallë rritjeje vjetore prej 2,86% (shkalla e rritjes së regjistrimeve të papunëve). Edhe pse krahasuar me vitet e kaluar vërehet një përparim, prapëseprapë dinamika dhe kapacitetet aktuale të ekonomisë së Kosovës në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës janë të kufizuara.

Tregut të punës për çdo vit i shtohen rreth 22000 punëkërkuës të rinj

Mosha e re e popullsisë është një nga indikatorët i cila ka bërë që numri i të papunëve përkatësisht numri i punëkërkuësve të rinj në tregun e punës të rritet nga viti në vit, dhe në këtë kontekst shtohet edhe trysnia mbi tregun e punës. Në këtë drejtim sipas grupmoshave papunësia më e lartë është për moshën 25-40 vjeçare, ndërsa tregut të punës mesatarisht për çdo vit i shtohen rreth 22000 punëkërkuës të rinj.

Sa i përket nivelit të kualifikimit të punëkërkuësve gjatë vitit të kaluar, grupi i punëkërkuësve "të pakualifikuar" paraqesin numrin më të madh të të papunëve dhe numrin më të madh të regjistrimeve të reja gjithashtu me 60% të pjesëmarrjes, ndërsa të punësuarit e nivelit të kualifikimit "shkollë e mesme" përfaqësojnë rreth 26% të pjesëmarrjes në tërësi.

Të papunët më nivel më të lartë të arsimimit karakterizohen me një situatë më të përshtatshme ngase në mënyrë kontinuele realizojnë shkallë të lartë hyrjeje në tregun e punës.


Shikuar nga regjistrimet, vetëm në vitin e fundit të cekura më lartë

Sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosova paraqet vendin me nivelin më të lartë të papunësisë shikuar në raport me vendet në rajon, ndërsa krahasuar me vlerën mesatare të papunësisë në BE, papunësia e Kosovës është rreth 4,5 herë më e lartë

konstatohet që fluksi i kërkesave për hyrje në tregun e punës është në rritje e sipër, megjithëse vendi ynë ballafaqohet me dinamikë të ngadalshme të krijimit të vendeve të reja të punës dhe pamundësi për përkujdesje të mirëfilltë sociale të njerëzve që kanë nevojë për punë.

Me gjithë problemet e shumta me të cilat përballlet, sektori privat ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në zbutjen e papunësisë ngase vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i të punësuarve rreth 67 % e tyre janë të punësuar në sektorin privat.

Në përgjithësi nëse shikojmë situatën e tanishme të papunësisë mund të përfundojmë se problemi i papunësisë përkatësisht çështja e zbutjes së saj do të mbetet në agjendë në vendin tonë edhe në vitet në vijim. Prandaj, çështja që shtrohet në vijim është gjenerimi i vendeve të reja të punës, për të absorbuar në një masë të madhe gjithë kërkesat për punë dhe mbajtjen në kontroll të papunësisë. Stabiliteti ekonomik afatgjatë, krijimi i mundësive për investime, promovimi dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i sektorit privat si dhe reformat në sistemin arsimor në drejtim të avancimit të tij janë disa nga faktorët thelbësorë të cilët do të kontribuonin në zbutjen e papunësisë dhe mbajtjen e saj në nivel të dëshiruar. ■



Korrespondencë nga Shkupi

Shqiptarët e Maqedonisë pas pavarësisimit të Kosovës



Avni AVDIU

Prandaj, edhe kësaj radhe pavarësia e Kosovës, aq shumë e pritur për shqiptarët e Maqedonisë, përkaj gëzimit të përjetuar nga ndjenja e atdhetarisë, kuptohet edhe si përforsim i pozicionit të tyre.

Dy shtetet shqiptare duhet t'i koordinojnë politikat e tyre

Tashmë dy shtetet e ardhshme shqiptare duhet t'i koordinojnë politikat e tyre bashkërisht. Dorën në zemër zëri i Shqipërisë nuk ka qenë edhe aq i fuqishëm në artikullimin e të drejtave të bashkëkombësve të vet në arenën ndërkombëtare. Kjo nuk rrodhi nga plogështia politike e shtetit amë, por nga problemet e brendshme të konsolidimit shtetëror me të cilat preokupohej. Njëherë e përballur nga vetizolimi ideologjik, pastaj me sfidat e tranzicionit dhe tash me angazhimet për integrimet veriatlantike e BE, Shqipëria nuk qe në gjendje t'i alarmonte instancat ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të bashkëkombësve të saj jashtë kufijve shtetëror. E deshi fati që e mira të vie e dyfishuar: pra krahas pavarësisë, Kosova të bëhet shteti që integrohet më së shpejti në BE, kuptohet përmes misionit të instaluar pas shkuarjes së atij të UNMIK-ut. Kjo do t'i ofrojë asaj mundësi të shumëfishta: si në stabilitetin politik (duke i shtrënguar politikanët që të mos korruptohen) ashtu edhe në atë ekonomik (duke i shtuar investimet e huaja dhe prosperimin e ekonomisë). Nga ana tjetër, kur kësaj i shtohet ftesa që i është bërë Shqipërisë për të qenë shteti i radhës për anëtarësim në NATO dhe mundësia e saj për t'u inkuadruar në këtë mënyrë edhe në BE për një afat kohor sa më të afërt, atëherë pozicioni i shteteve shqiptare në Ballkan duket nga më të fuqishmit. Zaten SHBA-ja nuk ka aleat më besnik në këtë rajon se shqiptarët.

Së këtejmi një Shqipëri e fortë dhe një Kosovë gjithashtu e fortë janë bazament i fuqishëm për të qenë një komb më i ngritur në

të gjitha aspektet. Prandaj, duhet shfrytëzuar kjo që në ditët e para të pavarësisimit të Kosovës.

Sa i përket Maqedonisë i gjithë ky zhvillim politik, duhet t'i shërbejë këtij vendi që të kthjellët njëherë e përgjithmonë. Maqedonasit (ndonëse ndodhi konflikti i vitit 2001) nuk mund të kenë aleat (nga fqinjët) më besnikë se shqiptarët. Problemi madhor i emrit me të cilin tash po përballet ky vend, mund të tejkalohet vetëm duke qenë në koherencë të plotë me faktorin shqiptar. Çdo përplasje me shqiptarët para së gjithash është vetëm në dëm të tyre. Prandaj lipset implementimi sa më i shpejtë i Marrëveshjes së Ohrit, prandaj lipset ndërtimit i raporteve të relaksuara ndëretnike, prandaj lipset bashkëpunimi reciprok ekonomik ndërmjet dy shteteve shqiptare dhe Maqedonisë, prandaj, prandaj...

Maqedonia duhet ta sjell ndërmend politikën shekullore të Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë ndaj saj dhe pretendimet e tyre. Tendosja me shqiptarët do të thotë për maqedonasit vetëvrasje me dëshirë.

Gëzon fakti se në këtë drejtim politika maqedonase e viteve të fundit të vetmen meçuri që ka treguar është që po mban qëndrim konstruktiv rreth pavarësisimit të Kosovës. Kjo tregon dhe dëshmon se ekziston pjekuria politike dhe se tashmë nevojitet vetëm se edhe gatishmëria për të qenë edhe më të vendosur për një politikë më proeuropiane, jo vetëm në planin e jashtëm, por edhe të brendshëm...

Së këtejmi Maqedonia nuk duhet të hezitohet në asnjë çast që të jetë sa më e hapur me shqiptarët, sepse tekefundit kjo është në interesin e tyre kombëtar. Prandaj problemet me të cilat deri më tani përballet vendi mund të tejkalohen vetëm bashkërisht e jo duke u shikuar me sy vëngër. Të qenurit sa më afër njëri-tjetrit, ofrimi i mundësive të barabarta dhe bashkëpunimi reciprok nën frymën e tolerancës dhe mirëkuptimit në të gjitha sferat janë çelësi i zgjidhjes së problemeve. E kundërta mund të ishte me pasoja të pariparueshme për Maqedoninë dhe do t'i kushtonte këtij vendi pasoja të pallogaritshme në qenjësimin e saj. ■

Pavarësimi i Kosovës, shqiptarët e Maqedonisë i gëzon pa masë. Ata si dhe vëllezërit e tyre në Kosovë, Shqipëri, trojet e tjera etnike si dhe në diasporë e kanë pritur këtë ditë me padurim.

Edhe pse të preokupuar me hallet e tyre (politike, sociale, kulturore etj), ata gjithnjë prioritet e kanë pasur Kosovën. Sikur është nuhatur se pikërisht Kosova është një gordiane edhe për ta.

Shqiptarët e Maqedonisë solidaritetin e tyre me vëllezërit nga Kosova e manifestuan në të gjitha format e mundshme gjerë tek inkuadrimi në radhët e forcave çlirimtare. Kosova ka qenë dhimbja, por edhe krenaria e tyre. Me të lidhej identifikimi mbarëkombëtar dhe kjo kontribuoi në rritjen e kohezionit brendapërbrenda faktorit shqiptar. Ishte pikërisht Kosova, ajo që kur përmendej binin përdhe të gjitha ndasitë dhe ndihej një refresh i genies kombëtare. Shqiptarët e Maqedonisë e kanë ndier edhe në kurriz të tyre dhunën sistematike që ushtrohej më parë nga regjimet serbo-sllave. Pasojat e tyre reflektoheshin edhe në Maqedoni, sepse eksperimenti kundërshqiptar herë fillonte atje e herë këtu. Kështu lidhej fati i përbashkët ogurzi. Andaj, çdo gjë pozitive që lëvizte në Kosovë, kuptohej si sinjal se diçka do të ndërronte edhe në Maqedoni.



Reportazh nga fshati Qabër

Aty ku ka gjallëri e vullnet për jetë

Sot në Qabër jetojnë 169 familje, që përbën 11 për qind të popullatës së komunës së Zubin Potokut

Florije ADEMI

QABËR, SHKURT 2008

Qabra i vetmi fshat i banuar me popullatë shqiptare në komunën e Zubin Potokut, në veri të Kosovës, shfaqet me plot gjallëri e vullnet për jetë.

Ndonëse gjatë luftës në Kosovë, ushtria dhe policia serbe dogji këtu çdo gjë shqiptare, duke e rrafshuar me tokë këtë vend, me përjashtim të një shtëpie trekatëshe atëbotë të porsandërtuar, të cilën e la “në këmbë”, siç thuhet për ta shndërruar në kishë.

“Kur jemi kthyer në fshat, askush nuk e ka ditë ku e ka trollin e vet se jo të gjej diçka nga pasuria, sepse fshatin e kishin rrafshuar me tokë”, kujton Afërdita Selimi, banore e këtij fshati.

Por, edhe në ato kushte qabrrasit të vendosur u kthyen në tokat e tyre për të vazhduar jetën, fillimisht në kampshtëpiza, të cilat ua dha qeveria japoneze, për t’iu rindërtuar më vonë (2001/02) shtëpitë me mjete të Qeverisë së Kosovës.

Përveç 20 personave të vrarë gjatë luftës dhe pesë të tjerëve që ende konsiderohen si të zhdukur, Qabra u ballafaqua edhe me dy raste tjera tragjike pas lufte: mbyrtjes misterioze të tre fëmijëve në

lumin Ibër, që për pasojë pati trazirat e marsit të vitit 2004, dhe më pas mbyrtjen edhe të dy fëmijëve të tjerë në gropat afër lumit.

Por jeta vazhdon. Sot ky fshat numëron 169 familje, që në bazë të statistikave të UNMIK-ut, përbën 11 % të popullatës së komunës së Zubin Potokut.

Në hyrje të fshatit, në anën e djathtë është në përfundim e sipër një xhami. Në anën e kundërt të saj, gjendet një pllakë me emrat e dëshmorëve të fshatit, përballë së cilës shfaqen shtëpitë e reja.

Një rrugë e shtruar me zhavorr të shpie deri në qendër të fshatit, te objekti shkollor, që konsiderohet si shkolla më e mirë në këtë rajon, ku vijojnë mësimin 220 nxënës.

Pak metra më larg ndodhet ambulanca në të cilën punojnë çdo ditë dy teknikë medicinal, ndërkaq një ditë në javë (të martave), vjen t’i kontrolloj pacientët qabrras një mjek nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë.

“Nuk kemi kërkuar nga shëndetësia e Zubin Potokut që të dërgoj mjek këtu te ne. Në këtë aspekt ne jemi të lidhur me shëndetësinë e komunës së Mitrovicës” thotë Qerkin Veseli, shef i Zyrës për Komunitete në këtë fshat.




Xhamia në ndërtim e sipër

Në afërsi të ambulancës ndodhet objekti i zyrës për komunitete, ku punojnë 11 qabrras, të cilët merren me dokumentacionet e ndryshme të banorëve të këtij fshati.

Veseli : Asnjëherë nuk kemi pas probleme me komunën e Zubin Potokut

Ndonëse puna e tyre lidhet direkt me komunën e Zubin Potokut, shefi i kësaj zyreje, Qerkin Veseli, thotë se asnjëherë deri më tani nuk kanë pas ndonjë prob-



Pamje nga fshati Qabër



Shkolla e re e fshatit

lem me komunë. Certifikatat e kurorëzimit janë një rast specifik, të cilat nuk mund të merren në këtë komunë, po për tu bërë kurorë, qabrasit shkojnë në Mitrovicë, përndryshe me dokumente të tjerë nuk kanë ndonjë problem.

Përveç punës me dokumentacion, ai numëron edhe shumë projekte të realizuara përmes kësaj zyreje, duke filluar nga rindërtimi i shtëpive, pastaj shkollës, ambulancës, zyrës për komunitete, ujësjellësit, shtrimin të rrugës në zhavorr, etj.

Por qabrasit nuk ndalen me ato që kanë realizuar. Zyra për komunitete vazhdon me projekte tjera duke u krijuar kushte sa më të mira për jetë banorëve të këtij fshati të vetëm shqiptarë në këtë komunë.

Janë në përfundim e sipër projektet për elektrifikim, që financohet nga UNHCR-i dhe kanazilimi, që financohet nga AER-i, shuma e mjeteve për implementimin e të cilave arrin vlerën në rreth 134.000 euro.

Edhe pse janë pakicë në këtë komunë të banuar me shumicë serbe, banorët e Qabrës thonë që nuk janë të privilegjuar sikurse që janë serbët në komunat tjera të Kosovës, ku numërohen si minoritet.

“Nuk jemi të privilegjuar ne si pakicë në këtë komunë, por i shfrytëzojmë të drejtat tona të garantuara me ligj” thotë zyrtari Veseli.

Nga ky fshat aktualisht janë të punësuar mbi 40 vetë, (duke përfshi këtu edhe mësimdhënësit) që marrin pagë nga Komuna e Zubin Potokut.

Flitet se vetëm zyra e shërbimit civil nuk punon me sistemin paralel, përndryshe të tjerat po. Në objektin e Zyrës për komunitete funksionon edhe Zyra e Qendrës për përkrahje sociale e drejtuar nga Shahin Zuka, e cila vazhdon të ndihmojë shumë familje të këtij fshati me gjendje të vështirë ekonomike. Sipas Zukës dhe aktivistëve të tjerë aktualisht qabrasit po presin vendosjen në funksion të centralit telefonik, pasi ata telefonin e kanë pasur edhe para lufte, ndërkohë që asfaltimi i rrugës në fshat, mbetet prioritet i projekte që synojnë t'i realizojnë në të ardhmen. ■



**Shtëpia e dedikuar për kishë
I vetmi objekt që i shpëtoj shkatërrimeve të luftës**

Universiteti i Prishtinës ka shënuar 38 vjetorin e themelimit

Simbol i dijes, rezistencës dhe çlirimit të Kosovës

Gëzim QERIMI

Universiteti i Prishtinës (UP) është një institucion i ri, por gjykuar nga ajo që është bërë, ky Universitet paraqet një institucion dinjitoz që ndjek trendët euro-atlantike mbi arsimin e lartë, ka thënë rektori i këtij universiteti prof. dr. Enver Hasani në ceremoninë solemne të kremtimit të 38 vjetorit të themelimit të UP-së.

Rektori Hasani ka shprehur bindjen se pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, Universitetit publik të Prishtinës do t'i hapet rruga për anëtarësim në sistemin e Bolonjës. Ai e ka cilësuar këtë universitet si simbol të dijes, rezistencës dhe çlirimit të Kosovës.

“UP-ja ka luajtur rolin e vet që i takon. Kemi bërë reformimin e planeve mësimore sipas kërkesave të Bolonjës, duke korigjuar veprimet nga e kaluara si dhe kemi ndërmarrë hapa serioz në krijimin e një infrastrukture institucionale për ngritjen e cilësisë në studime, duke angazhuar ekspertë vendas dhe të jashtëm për këtë qëllim”, ka thënë rektori Hasani, duke shfaqur bindjen se ky universitet e ka një të ardhme evropiane dhe së shpejti do të mund të krahasohet me të gjitha universitetet tjera ndërkombëtare.

Ndërsa, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prof. dr. Enver Hoxhaj, ka theksuar se puna që është bërë në UP meriton vlerësim dhe lëvdata dhe duhet të çmohet nga shoqëria, duke shtuar se pavarësisht arritjeve, mbetet ende vend për përpjekje që UP-ja të jetë konkurrent i denjë i universiteteve evropiane dhe burim i dijes në Kosovë. Sipas ministrit Hoxhaj, sigurimi i cilësisë, edukimi për ekonominë në mënyrë që të rinjtë të gjejnë vende pune, mbeten sfidë për UP-në. “UP-ja duhet të ketë një funksion të tij, modernizimin e shoqërisë, i cili çdo herë duhet të ketë njerëz që me diplomat e tyre të jenë në gjendje të konkurrojnë në tregun e punës në rajon e më gjerë”, ka thënë ministri Hoxhaj duke shprehur bindjen se UP-ja është në rrugën e mbarë dhe do të jetë motor i modernizimit të shoqërisë “siç ka qenë më herët motor i ilimnizimit dhe çlirimit të Kosovës”.

UP-ja sikurse për çdo përvjetor, edhe kësaj radhe ka ndarë çmimin “Student i Dalluar” për 48 studentë nga të gjitha fakultetet. ■



Qeverisja e mirë, paqja dhe perspektiva në Kosovë

Synimet dhe qëllimet parësore kryesore dhe permanente të udhëheqjes, qeverisjes rrjedhimisht qeverisjes së mirë janë mirëqenia ekonomike dhe sociale, perspektiva e vazhdueshme, progresi dhe paqja. Kjo do të thotë edhe koekzistenca paqësore midis popujve dhe kombeve, qoftë në nivel nacional apo në atë global...



Dr. Mazllum BARALIU

Qeverisja paraqet orientimin e sjelljes së individit dhe grupit të caktuar drejt qëllimeve të definuara. Ajo nënkupton edhe procesin e planifikimit, organizimit, motivimit, koordinimit, kontrollit në një rën anë, por edhe zbatimin e synimeve, qëllimeve, objektivave dhe detyrave paraprakisht të koncipuara, si dhe përgjegjësive, gjithnjë në dobi të qytetarëve të një vendi, pa dallim.

Synimet dhe qëllimet parësore kryesore dhe permanente të udhëheqjes, qeverisjes rrjedhimisht qeverisjes së mirë janë mirëqenia ekonomike dhe sociale, perspektiva e vazhdueshme, progresi dhe paqja. Kjo do të thotë edhe koekzistenca paqësore midis popujve dhe kombeve, qoftë në nivel nacional apo në atë global, pra lulëzimi i paqes, prosperitetit dhe perspektivës universale midis njerëzve dhe popujve kudo dhe kurdo në botë.

Qeverisja dhe procesi i vendimmarrjes apo i vendosjes është i ndërlidhur pashkëputshmërisht me qeverisjen si proces multiplikativ dhe tejet kompleks. Vendosja apo vendimmarrja në

të vërtetë në vete ngërthen definimin e problemit, çështjes apo problemeve të caktuara të përgjithshme apo specifike, pastaj mbledhjen e të dhënave, analizën e alternativave, gjetjen e shtimeve optimale, zbatimin e tyre dhe matjen e rezultateve. Qeverisja e mirë ndërkaq po të jetë cilësore dhe dobi-sjellëse duhet të jetë e dedikuar dhe e ndërlidhur me popullin dhe për popullin dhe vendin e caktuar. Ajo në të vërtetë dallon nga nocioni Qeverisje. Si e tillë, qeverisja e mirë kërkon edhe planifikim të mirë, interval të caktuar kohor, resurse adekuate, e mbi të gjitha ndërgjegje dhe mirëkuptim.

Faktorët relevantë ndikues dhe implementues të qeverisjes së mirë

Qeverisja e mirë apo më mirë të themi procesi i qeverisjes, përgjithësisht nënkupton amplifikimin dhe involvimin aktiv, progresiv dhe permanent multifaktorial dhe kolektiv, pra gjithëpërfshirës të një vister subjektësh apo aktorësh siç janë:

- shteti (te ne Qeveria) – institucionet;
- shoqëria civile (OJQ-të, mediat etj.);
- sektori privat.

Cilat janë parakushtet, obligimet dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës apo më saktësisht të qeverisë së Kosovës për një qeverisje të mirë dhe të qën-

drueshme, e cila domosdoshmërisht do të duhej të prodhonte perspektivë, paqe dhe stabilitet. Ndër më kryesoret janë:

- Krijimi i kushteve optimale për zhvillim propulziv ekonomik përmes: tregut të lirë, investimeve, politikave adekuate fiskale, përforsimit të zhvillimit sektorial të bujqësisë, industrisë, turizmit etj.;

- Avancimit të procesit dhe infrastrukturës ligjore. Gjë që në Kosovë ka shumëçka për të dëshiruar në përmirësimin e kësaj gjendjeje jashtëzakonisht të pavolitshme, ngase shumë ligje vonohen, të tjerat janë të mangëta; një tjetër kategori ligjesh miratohet nga Kuvendi por nuk nënshkruhen nga përfaqësuesi special, ndërsa një tjetër numër i madh mbi 70 ligje të Kosovës nuk zbatohen në jetën e përditshme ndonëse të miratuara.

- Krijimi i mekanizmave për funksionimin e standardeve të nevojshme të të drejtave dhe lirive të njeriut për të gjithë pa dallim;

- Kultivimin e procesit të tolerancës dhe pajtimit përmes sistemit të arsimit, komunikimeve direkte midis njerëzve të komuniteteve të ndryshme në Kosovë, me një fjalë harmonizimi i veprimeve, nevojave dhe interesave qytetare në kushte të një tolerancë dhe të një hapësire demokratike të qëndrueshme.

- Instalimi i një sistemi human, solidar dhe intergjenerativ të sigurimit dhe mbrojtjes sociale;

- Avancimin e punës dhe përgjegjësisë të institucioneve të Kosovës, marrja e kompetencave të plota dhe përgjegjësisë nga UNMIK-u, rrjedhimisht nga EUMIK-u ose EULEX-i i ardhshëm;

Hapja dhe zhvillimi aktiv dhe dinamik i dialogut shoqëror midis institucioneve dhe shoqërisë civile si dhe dialogu social brenda shoqërisë të Kosovës;

- Fokusimi aktiv dhe intensiv i të gjitha segmenteve të shoqërisë të Kosovës në ndërtimin e koekzistencës paqësore për të gjithë, prosperitetit ekonomik dhe mirëqenies sociale...

Ky është prelude e paqes së qën-



drueshme, perspektivave zhvillimore afatgjate dhe investive në Kosovë. Këto do të ishin disa nga detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për një qeverisje të mirë në Kosovë.

Qeverisja e mirë dhe realiteti objektiv në Kosovë

Si është realiteti objektiv dhe gjendja e funksionimit të qeverisjes në Kosovë? Kemi apo jo qeverisje të mirëfilltë në Kosovë?! Këto janë pyetje të cilave do të përpiqemi t'iu japim përgjigje në vazhdim.

Pas një periudhe kohore të gjatë të represionit, terrorit shtetëror, të gjenocidit i përcjellur me holokaust, të një krize ekonomike të skajshme dhe të thellë, të shkallës më të lartë të papunësisë dhe të varfërisë në Evropë, Kosova është e lodhur dhe e dërmuar, ndërkaq gjendja sociale dhe ekonomike është tejet e rëndë dhe potencialisht shpërthyes.

Ata tre faktorët, dhe aktorët kryesorë që i përmendëm më parë në këtë shkrim, nuk e kanë rolin e duhur ose nuk e luajnë atë sa duhet dhe si duhet. P. sh. shteti nuk ekziston, ndërkaq qeveria nuk ka kompetenca të plota. Mirëpo gjendja është edhe më rënduese, dhe e keqja edhe më e madhe mu për shkak të faktit të pamohueshëm se edhe ato pak kompetenca që kanë institucionet tona dhe qeveria e Kosovës nuk ushtrohen si duhet, në mënyrë efikase dhe në dobi e shërbim të plotë të qytetarit. Shembulli i paradoditshëm i vdekjes së një qytetari në sportel duke pritur realizimin e së drejtës së vet minimale të asistencës sociale, është mjaft ilustrativ, indikativ dhe tejet qortues.

Sa i përket faktorit dhe aktorit të dytë relevant në qeverisjen e mirë – shoqërisë civile, ajo respektivisht komponentët e saj në radhë të parë organizatat joqeveritare, institutet dhe mediat, nuk e kanë apo nuk e luajnë rolin e duhur influencues në përmirësimin e gjendjes në aspektin e qeverisjes sa më cilësore, të ndërgjegjshme dhe të mirë në Kosovë.

Që nga paslufta e gjer më tani, në Kosovë janë formuar dhe kanë vepruar më pak apo më shumë sukses mbi 1000 OJQ, mirëpo efektet e veprimtarisë së

tyre në periudhën 8 vjeçare të zhvillimit në shoqërinë të Kosovës janë të parëndësishme, simbolike dhe shumë pak rezultateve.

Sektori privat është sa i papërvojë aq edhe galopant, i dezorganizuar dhe i shkapërderdhur. Aleanca të Kosovës e biznesit është një segment i rëndësishëm si formacion biznesmenësh i këtij sektori, por jo edhe sa duhet influencues dhe rezultatdhënës. Faktorët dhe shkaktarët për këtë janë të shumtë, por ne do veçojmë disa syresh. Kjo aleancë përpiket të koordinojë me Qeverinë, madje edhe me subjektet politike të Kosovës, me Odën ekonomike dhe ndonjë subjekt tjetër, por të gjitha këto nuk kanë kompetenca dhe ingjencia të mjaftueshme poaqsa vullnet te pamjaftueshëm për të ndryshuar gjendjen për të mirë. Kjo aleancë promovon konsumin e produkteve vendore, por në anën tjetër, në mos

qeverisje të mirë. Ekzistojnë disa formacione kuazistrukturale e kuazishtetërore ndërkombëtare, të cilat nuk ofrojnë qeverisje cilësore dhe dobijellëse për qytetarët e Kosovës.

Në Kosovë sot as flitet shumë dhe as bëhet mjaft për qeverisje të mirë, por duke u bazuar në faktin e një psikologjie dhe sjelljeje jashtëzakonisht tolerante dhe durimtare e mirëkuptuese të këtij populli, paqja mbretëron në Kosovë. Në Kosovë ende nuk ka qeverisje cilësore, por ka standarde ndërkombëtare më të larta për të drejtat e njeriut, ka tolerancë, humanizëm dhe ka paqe për të gjithë.

Emanuel Kanti në vizionin e tij të paqes perpetuale nga shekulli i XVIII-të veçon tri elemente themelore për qeverisje efektive dhe globale. Ato janë: Sundimi i ligjit, e drejta ndërkombëtare e zbatueshme obligative dhe njohja universale e të drejtave të njeriut.

Ndërlidhja midis qeverisjes së mirë dhe paqes e bërë nga Kanti që në shek. 18 është e qëndrueshme. Njerëzit që ndihen të sigurt dhe të lirë, të udhëhequr nga sundimi i ligjit dhe jo nga njeriu pushtetmbajtës, vështirë vendosin të luftojnë me njëri-tjetrin në relacion me ata që nuk udhëhiqen nga ligji, thotë ai. Ky konstatim jo vetëm që është i saktë dhe aksiomatik por është aktual edhe sot e kësaj dite.



angazhohet, atëherë toleron një numër të subjekteve të saj që të sillen jo vetëm në mënyrë të papërgjegjshme ndaj konsumatorit – qytetarit të Kosovës, por edhe në mënyrë të kundërligjshme duke manipuluar me cilësitë e produkteve, preamballazhimin e tyre, kontrollin e pa mjaftuar të ushqimit, riprodhimin apo riciklimin e materieve – mallra të skaduara për riprodhim të serishëm, dhe vënien e produkteve të tilla me vlera dhe cilësi të dyshimta në treg etj.

Kosova dhe qytetarët e saj lypset të kenë më shumë përgjegjësi, kompetenca dhe obligime qeverisëse, në mënyrë që të dëshmojnë se duan, dinë dhe mundën të ofrojnë qeverisje cilësore, të mirë, prosperitet, mirëqenie sociale, shpresë dhe paqe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët në Kosovë.

Mirëpo në realitet, sot në Kosovë jo vetëm që nuk ka shtet, por nuk ka as

Çka duhet ndërmarrë tani dhe në të ardhmen?

Për të ushtruar qeverisje të mirë dhe në mënyrë praktike, pra një qeverisje të perceptueshme dhe të mirëpranueshme nga qytetari i Kosovës, institucionet e Kosovës, lypset t'i zbatojnë këto elemente apo veçori esenciale parimore: siç janë përgjegjësia, transparencia, efikasiteti, pjesëmarrja në proces dhe planifikimi respektivisht parashikimi. Ndërkaq për të funksionuar mirë qeverisja e mirë duhet domosdoshmërisht të ekzistojë interaksioni i përhershëm dhe i pandërprerë midis forcave progresive shoqërore, veçanërisht midis tri subjekteve apo aktorëve të sipërpërmendur, natyrisht duke i aplikuar në tërësi dhe vazhdimisht parimet respektivisht veçoritë e parapërmendura. ■

“Trendi” i shkurorëzimeve trondit Kosovën

Numri i shkurorëzimeve në Kosovë është në rritje të vazhdueshme që nga paslufta. Sipas psikologëve janë disa faktorë që ndikojnë në kërkimin e përfundimit të lidhjes martesore ndërmjet bashkëshortëve... shkurorëzimet e prindërve ndikojnë negativisht në zhvillimin psikologjik dhe social të fëmijës



Florentina LATA

A.B. (28) kishte ndryshuar qëndrim ndaj bashkëshortes së tij dhe më nuk e dashuronte sikur më parë. Plotë tri vite martesë dhe emocione të forta të dashurisë, ai i kishte harruar për një çast kur i kishte ardhur një ofertë për të shkuar në Gjermani dhe për t’u martuar me një vajzë nga atje. Ai i entuziazmuar për këtë rast, kishte gjetur menjëherë formën për të ikur nga Kosova në drejtim të një jete të re që synonte ta fillojë. A.B. kishte gjetur mënyrën për tu shkurorëzuar nga bashkëshortja e saj dhe kështu kishte vendosur t’ia “mbathtë” rrugës së mërgimit ku do ta priste femra, e cila do t’ia bënte “letrat” e leje qëndrimit në atë shtet.

Bashkëshortja e tij M.B. (23) ishte munduar ta bind burrin e saj që mos ta braktisë atë, dhe dashurinë e tyre, mirëpo ai nuk kishte dashur as të dëgjojë. Kishte shkuar drejtë e në organet e gjykatës komunale në Prishtinë për të kërkuar shkurorëzimin nga bashkëshortja e tij. Pas disa procedurave kishte arritur të ndahet nga bashkëshortja të cilës ia “dhuron” edhe vajzën e tyre njëvjeçare që të përkujdeset për të.

M.B. ishte detyruar të pajtohet me fatin dhe të kthehet të prindërit e saj.

Ajo thotë se nuk ka pasur çka të bëjë pasi që burri i saj ka “lakmuar” në vajza tjera dhe në një jetë më të mirë. “Ne jemi dashur shumë, sepse me dëshirë jemi njohur dhe vet kemi vendosur të marthemi. Ai çdoherë më ka puth dhe më ka përqafuar sa herë që ka ardhur prej qytetit. Nuk e di, ai ka qenë një djalosh tërheqës, por pse u ndikua prej këtij rasti, thjeshtë nuk e di çka të them...”, kujton M.B. e cila edhe pse tash llogaritet si një femër e ve, thotë se nuk mërzhitet nëse do të gjej burrë tjetër sepse ish-bashkëshorti ia ka “gërdit” jetën martesore.

M.B. jeton në shtëpinë e babait të saj në Prishtinë, dhe tashmë ka gjetur një punë dhe është e lumtur me kushtet që i ofrohen nga familja e saj. “Këtu nuk më mungon asgjë, por ende më dhemb ajo çka më bëri bashkëshorti im që iku dhe më la. Ka qenë djaloshi i parë në jetën time dhe fatkeqësisht po vazhdoj shumë ta dua edhe pse nganjëherë po e urrej...”, shprehet ajo derisa tregon një fotografi të ish-burrit të saj.

M.B. të gjithë meshkujt i quan “idiotat” dhe u bënë thirrje vajzave tjera që të kenë shumë kujdes kur të vendosin të hyjnë në lidhje martesore me ndonjë mashkull, sepse mund ta kenë fatin e njëjtë sikur ajo. Madje, siç shprehet M.B. ka edhe femra që vet gabojnë dhe me dëshirë e zgjedhin shkurorëzimin. “Kom digjuar disa herë për lloje të ndryshme të shkurorëzimeve fajtoje të së cilës kanë qenë vet femrat, duke e tradhtuar dhe duke mos e respektuar aspak burrin e tyre”, përfundon rrëfimin e saj, me dëshirën e vetme që me vajzën ta fillojnë një jetë të re pa shikuar fare nga e kaluara.


Megjithëkëtë, ka edhe shumë qifte tjera bashkëshortore që nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët në jetë dhe si formë të vetme gjejnë shkurorëzimin, edhe pse kjo mund të ndikojë negativisht tek fëmijët që mund të kenë.

Agani: Shkurorëzimet ndikojnë negativisht te fëmijët

Psikologu Ferid Agani thotë se shkurorëzimet gjithmonë ndikojnë në mënyrë patologjike të fëmijët. Ndryshe sipas tij, kjo bart efekte negative tek zhvillimet psikologjike të fëmijëve,

sepse krijon ankth, frikë, pasiguri dhe e detyron atë të bëjë ndarje emocionale ndaj njërit prind. Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar, siç shprehet ai kanë një zhvillim të ngadalësuar dhe të çrregulluar psikologjik.

Agani mendon se shkurorëzimet janë një fenomen i cili e përcjell shoqërinë njerëzore qysh nga kohërat e lashta. Mirëpo sipas tij, posaçërisht në kohërat moderne ky fenomen paraqitet në raste më të shpeshta. “Kjo dukuri mund të bëhet më e shpeshtë sidomos në periudhat e tranzicionit kulturor kur me të madhe ndryshohen rolet e meshkujve dhe të femrave në shoqëri, por edhe në bashkëshortësi brenda familjeve”. Ai thotë se ky ndryshim i roleve dhe i sistemit të vlerave ka reperkusione. Në



Agani: Janë shumë faktorë që sjellin deri te shkurorëzimi

dinamikën familjare sipas Aganit, vjen deri te një konflikt ndërmjet interesave personale, psikologjike të gruas dhe të burrit. “Në këto raste nuk ekziston një lidhje e fort e dashurisë e cila do t’i mbante ata së bashku. Por, interesat personale mbizotërojnë dhe në një moment secili prej bashkëshortëve fillon të jetojë duke e shfrytëzuar tjetrin për nevojat e veta”. Sipas tij, janë shumë faktorë që sjellin deri të shkurorëzimi. Ai thotë se janë rastet sociale, problemet e natyrës

individuale psikologjike, sëmundjet e rënda psikiatrike dhe trupore etj, që ndikojnë në shkurorëzim. “Shkurorëzimet për fat të keq janë në një numër që po rritet vazhdimisht në Kosovë, por shifra të sakta nuk dihen pasi që kjo dukuri është e maskuar, sepse kemi të ashtuquajtura shkurorëzime artificiale dhe ato që kanë rregullim të dokumentacionit”, nënvizon Agani. Gjithashtu Agani flet edhe për mënyrat e parandalimit të kësaj dukurie që sipas tij, me krijimin e këshillimoreve para martesës mund të bëhet këshillimi i qifteve të cilët dëshirojnë të hyjnë në martesë. “Qiftet duhet të këshillohen psikologjikisht se çfarë sfida i presin në procesin e jetës bashkëshortore dhe të përgatiten për anët specifike në mënyrë që të mos befasonen dhe të mos janë pre e zhvillimeve të pa kontrolluara në bashkëshortësi”, këshillon Agani.

Podvorica: Në Kosovë shkurorëzimet janë të rregulluara me ligj ng t'n sot nuk ke

Profesori i të drejtës familjare në Universitetin e Prishtinës, Hamdi Podvorica, thotë se martesat mund të zgjidhen vetëm nëse marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Sipas tij, pa ekzistimin e shkaqeve të parashikuara me ligj martesat nuk mund të shkurorëzohen parësish nga vullneti i bashkëshortëve. “Në martesat me fëmijë edhe ligjvënësi kosovar edhe gjykata një theks të posaçëm i kushton mbrojtjes së interesave të fëmijëve të mitur”, thotë Podvorica. Sipas tij, gjykata ka për detyrë që të bëjë vërtetimin e të gjitha fakteve relevante që dërgojnë në drejtim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve. Ai thotë se organi i kujdestarisë duhet gjykatësi t’ia paraqes një mendim dhe një konsultim me shkrim ku duhet të vërtetohet interesi i fëmijës, nëse duhet të jetojë me babin apo me nënën. “Që fëmija t’i takoj babait gjykata merr parasysh kushtet jetësore nëse ka banesë, gjendjen materiale të mirë dhe nëse i ati është në gjendje ta ushtroj me dinjitet të drejtën prindërore, atëherë natyrisht fëmija do t’i takoj të atit, por nëse është e kundërta nëse i ati nuk është në gjendje për tu kujdesur për fëmijën atëherë fëmija i takon nënës nëse ajo i plotëson kushtet. Mirëpo, nëse në martesë kanë shumë fëmijë dhe

Viti 2007, vit rekord i shkurorëzimeve

Sipas statistikave zyrtare të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë, shihet se nga viti në vit, numri i atyre që janë shkurorëzuar është në rritje të vazhdueshme. Sipas këtyre statistikave në vitin 2000 ka pas 351 raste të shkurorëzimeve, kurse në vitin 2007 është rritur në 717 shkurorëzime.

2000- 351 raste;
2001- 412 raste;
2002- 546 raste;
2003- 692 raste;
2004- 676 raste;
2005- 626 raste;
2006- 676 raste;
2007- 717 raste të tilla.

ata fëmijë janë mbi moshën 10 vjeçare, atëherë gjykata në procedurë do të marrë mendimin e fëmijës dhe kur ka shumë fëmijë, atëherë gjykata zakonisht bën përpjekje që të gjithë fëmijët ti takojnë

njërit prej prindërve”, sqaron profesori derisa thekson se ka raste kur fëmijët u takojnë të dy prindërve nëse këta të fundit kanë kushte dhe të dy prindërit e ushtrojnë të drejtën princore. Sipas tij, prindit të cilit nuk i takon fëmijët ai ka të drejtë të takohet me ta, t’i mbaj dhe të paguaj alimentacionin për çdo fëmijë në muaj në mënyrë që fëmijës t’i krijohen kushtet normale për zhvillim.

Podvorica thotë se pas ndarjes së bashkëshortëve bëhet edhe ndarja e pasurisë së përbashkët e cila është ndërtuar gjatë jetesës dhe punës së përbashkët të tyre. “Sipas ligjit të familjes të Kosovës pjesëtimi i pasurisë bëhet pas zgjidhjes së martesës, në qoftë se njëri nga bashkëshortët ka krijuar të ardhura më shumë se bashkëshorti tjetër atëherë burrit do t’i takoj një hise më e madhe. Mirëpo, derisa të ekzistoj një martesë e më hershme në asnjë mënyrë nuk mund të ekzistoj një martesë e re. Pas zgjidhjes së martesës gruaja ka të drejtë ta kthej mbiemrin e saj të vajzërisë, bashkëshorti i cili është fajtor duhet të bëjë edhe kthimin e dhuratave me vlerë”, thotë për fund profesori i të drejtës familjare Hamdi Podvorica. ■



Çfarë do të thotë të jesh i ri në Kosovë?



Emine A. VEZAJ

“Shpesh dëgjojmë se rinia thotë: nuk dua të jetoj sipas arsyes së tjetrit, do të mendoj vet. E pse të mendohet për atë që është e njohur. Merr ç’është e gatshme dhe shko më tej. Këtu qëndron fuqia e njerëzimit”.

Leon Nikollaeviq Tolstoj

Për të gjithë ne është e rëndësishme mënyra e jetesës dhe interesi se si duhet ta kalojmë atë, dhe për këtë secili mundohemi dhe kontribuojmë që të kalojmë sa më mirë. Tani a janë të gjithë në gjendje të kontribuojnë për një jetë më të mirë në vendin e tyre? Si duket jo ngase edhe pse disa janë të pasur, disa janë të mesëm disa janë të varfër, prapëseprapë secili ndien nevojën të shoh botën me sytë e tij, thuajse secili ka ëndrra të njëjta sikurse edhe të bashkëmoshatarëve të tij, secili ka dozë pesimizmi në jetën të cilën është duke e jetuar çdonjërin që takon në rrugë, dyqan, kafeteri apo vende tjera publike shpreh pakënaqësinë me jetën që është duke jetuar, secili konsideron se ka një ëndërr të porealizuar, largimin nga vendi i lindjes. Jo të gjithë kanë prioritet studimet. Shumica prej tyre të pakënaqur me jetën që bëjnë, ua mësyjnë shteteve të ndryshme, duke pretenduar sukses më të madh, nga puna diku tjetër se sa në Kosovë. Çdo student edhe me gjithë rezultatet e shkëlqyera në vendin e tij sërish pa hamendje do t’i thoshte PO një oferte për të studiuar jashtë vendit. Ku është problemi që këta të rinj preferojnë vendet e huaja, çfarë do të thotë për ta të jesh i ri në Kosovë, sa kanë përkrahjen institucionale..., janë vetëm disa nga pyetjet të cilave do të përpiqemi t’iu japim përgjigje në këtë shkrim.

Radhët e gjata para dyerve të ambasadave të huaja...

Edhe pse të gjithë të dashuruar në vendlindjen dhe krenar me vendin të cilin kanë lindur, pak prej tyre do të preferonin t’i qëndronin besnik “dashurisë” së tyre. Ideja e të qenit më mirë në një vend tjetër nuk ndryshon aspak perceptimin se tani për tani në Kosovë nuk ka asnjë perspektivë për të rinjtë. Me rrugën që marrin në punët që kryejnë, shumë

shpejtë do t’i thonë PO një oferte pune nga jashtë, sepse të gjithë kanë një synim të përbashkët, ndryshimin e mënyrës së të jetuarit. Shumica prej tyre si mundësi të vetme kanë përzgjedhur rrugën e kurbetit me shpresë se një ditë do të mund të plotësojnë nevojat e një jete më të mirë krahas asaj në të cilën kanë qenë më parë. Jo pak prej tyre kanë vendosur të largohen nga më të dashurit e tyre, larg familjes, larg vendlindjes, por me një qëllim të caktuar, ndryshimin e standardit jetësor nga ajo në të cilën tashmë kanë bërë një moshë dhe ndien të pakënaqur. Shumica prej tyre kanë hallin e bashkimit familjar, një pjesë prej tyre synojnë që të gjejnë rrugën e suksesit për një jetë më stabile, ndërsa një pjesë tjetër dëshirojnë të formojnë personalitetin e tyre në Uni-



versitet e huaja, duke qenë të bindur se në ato Universitete, cilësia e studimeve është shumë më e lartë se sa në Kosovë.

Radhët e gjata para dyerve të ambasadave të huaja në pritje të ndonjë rezultati për dokumentet e tyre shpeshherë na kujtojnë dy gjëra: ethet e pritjes për të hyrë në ndonjë provim, dhe radhët e gjata të pritjes së refugjatëve nëpër kampe gjatë luftës për të marrë ndonjë ndihmë simbolike që na ofronin organizatat e ndryshme humanitare. Ndërsa, sot në rrethana paqeje ky realitet është trishtues.

Sa ka përkrahje institucionale rinia e Kosovës?

Përkrahja institucionale nga organet më të larta qeveritare është pothuajse e

paimagjinueshme. Mundësitë e të rinjve për të depërtuar në këto institucione janë të pakta ose nuk ekzistojnë fare. Aty vendet e punës tashmë janë të zëna nga një staf i “profesionalizuar” dhe nuk ndihet nevoja për kuadro të rinj. Të rinjtë refuzohen me arsyetim se nuk kanë përvojë pune që është e “domosdoshme” për të punuar në këto institucione. Shtrohet pyetja: Nga ta fitojnë përvojën nëse nuk u jepet mundësia?!

Nga ana tjetër “të profesionalizuarit” që punojnë në vendet kyçe të institucioneve në vend (të cilët në shumicën e rasteve janë të vjetër për nga moshën), pothuajse nuk janë të njohur aspak me botën e teknologjisë bashkëkohore, njohjen me kompjuter dhe internet, ndërsa nuk iu krijojnë hapësirë të rinjve që dinë ta përdorin teknikën moderne.

Çka i mbetet rinisë atëherë? Të shkojë në ndonjë kafeteri dhe të punësohet si kamerier ose në ndonjë internet kafe dhe të kërkojë nga pronari mirëmbajtjen teknike të kompjuterëve...

Në këtë gjendje janë të rinjtë e Kosovës. Ata, të dëshpëruar nga jeta sorollaten lartë e poshtë, ndonjëherë pa kurrfarë qëllimi vetëm për të humbur kohën...

Si përfundim, të jesh i ri në Kosovë do të thotë: nëse ke përfunduar shkollën e mesme dhe ke mundësi të mira materiale mund të regjistrohesh në ndonjë Universitet privat të Kosovës dhe ta përfundosh kur ta kënda qejfi, po deshe edhe për një vit!; nëse nuk ke mundësi materiale dhe ke resurse të mira intelektuale mund të përfundosh në Universitetin publik, dhe të mbarosh studimet me notën me të lartë mesatare, por që e nesërmja do të gjejë diku në ndonjë kafeteri të Prishtinës duke pirë kafën e mëngjesit vetëm me një euro në xhep; ose, të shesësh kartela mbushëse telefonike nëpër rrugë për ta siguruar kafshatën e bukës.

Kjo është Kosova jonë, ky është realiteti i hidhur me të cilin po përballet rinia e jonë. ■

Zinxhiri i një shoqërie të devotshme

Ne mund të mos jemi faktor influencues tek intelektualët e formuar, por mund të ndikojmë tek fëmijët tonë dhe tek familjet tona. Vetëm kështu mund të formohet zinxhiri i një shoqërie të devotshme, si ndërmjet bashkëkohësve, po ashtu edhe në gjeneratat pasuese



Mirsad KUTELI

Kauza e jetës është çështja kryesore, për të cilën çdo individ duhet të mendojë shpesh, por na ndodh që për një kohë të gjatë të mos e kujtojmë apo ta neglizhojmë.

Sa e sa çaste të jetës sime më kanë kaluar pa kuptuar edhe pse ato momente i kam shijuar apo përjetuar në mënyrë koshiente apo subkoshiente. Dikur më ishte bërë shprehje që në mbrëmje të përlllogarisja aktivitetet profitabile dhe joprofitabile gjatë mbrëmjeve para gjumit. Kjo në njëfarë mënyre është një praktikë që të bën të kuptosh më tepër vetveten, realitetin jetësor, etj. Megjithatë, nuk ishte e mjaftueshme përderisa edhe atëbotë nuk meditoja për shkakun e krijimit të njeriut, i pajisur me mendje, formë trupore të përkryer, të dalluar nga të gjitha krijesat tjera. Po kështu, edhe për krijimin e universit kishim përshtypje iluzore, ashtu siç ishin mendimet për planetin tonë. Ndërkaq, që të gjitha këto impresione do të merrnin fund në momentin e vetëdijesimit. Përkundër faktit se edhe sot, një pjesë e madhe e njerëzimit, mbase nuk e dinë apo nuk e kuptojnë qëllimin e krijimit të njeriut dhe rolin e tij në këtë botë. Andaj, besoj se mjafton vetëm një mendim i pastër, i çiltër dhe i vërtetë në një çast qetësie për një gjë, pra kaq të rëndësishme të jetës sonë. Mendoj se është koha kur duhet ta kuptojmë realitetin jetësor dhe të largohemi nga bota ireale. T'i kthehemi njëherë e përgjithmonë vetvetes. Të investojmë në veten tonë, me faktin se çdo gjë nis nga brenda, nga vetë ne. Me krijimin e karakterit tonë dhe me ngritjen morale të ndikojmë tek familja e ngushtë dhe rrethi ku jetojmë. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndryshohet bota për të mirë. Ne

mund të mos jemi faktor influencues tek intelektualët e formuar, por mund të ndikojmë tek fëmijët tonë dhe tek familjet tona. Vetëm kështu mund të formohet zinxhiri i një shoqërie të devotshme, si ndërmjet bashkëkohësve, po ashtu edhe në gjeneratat pasuese. Mirëpo, kur thash se çdo gjë nis apo lind nga brendia jonë, nga karakteri jonë, atëherë duhet pasur shumë kujdes në këtë pikë. Duhet të provojmë dhe dëshmojmë cilësitë më të mira njerëzore, në atë mënyrë që të jemi shembull për ata ku duam ta shtrijmë impaktin tonë.

Meditimi për gjenezën e jetës shpeshherë humbet labirinteve ...

Kjo botë është tepër interesante; sa atraktive aq edhe sfiduese, ndaj për këtë, pothuajse çdo njeri ka të paktën një vizion të tij rreth krijimit të kësaj bote.

Shikuar nga një prizëm, që madje mund të përsëritet disa herë në jetë, është një përsiatje që shpeshherë përfundon shumë shkurtimisht dhe pa konkluzion të definuar.

Së pari do të meditoj për krijuesin, pra Zotin e Madhërisëm, pastaj për njeriun, kafshët, insektet, natyrën në tokë, si dhe për qiellin. Pas gjithë këtyre mediti-

meve do të hasësh në një konfuzion.

Vërtetë është një labirint, pra një çështje delikate që të shtynë të kujtosh për një suportim apo mbështetje autentike. Të bën të mendosh se nga vish dhe ku do të shkosh.

Tashmë shumë gjëra janë sqaruar në botën moderne, mirëpo, edhe përkundër zbulimeve të mëdha akoma ekzistojnë mirakulli apo mistere, të cilat në të vërtetë të mahnitin. Kështu do të sprovohemi me gjëra të ndryshme në këtë botë, duke qenë spektatorë se si njerëzit e shfrytëzojnë mendjen si një nga tiparet më të veçanta nga të gjitha qeniet e gjalla në këtë botë.

Deri më tani janë përdorur shumë variacione studioze mbi njeriun dhe jetën. Në këtë aspekt, mendoj se në çdo këndvështrim të saj mund të dalë në retrospektivë një pikëpamje e kufizuar.

E tërë gama përfshirëse që njeriun e mban gjallë dhe me shpresë, artikulohet dhe konsiston në tri shtylla kryesore. Pikërisht këtu qëndron e tërë mbështetja e njeriut. Andaj, lindja, vdekja dhe ringjallja në botën e amshueshme janë ndër transmetimet bazike të religjionit. Këtu pra është dhe trekëndëshi mistik apo real, ku faktikisht duhet të bazohet dhe të orientohet mendja e njeriut racional. ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Shqetësime për zhvillimet në Kosovë



Demir RESHITI

Kosova ka vazhduar të jetë në krye të agjendës të institucioneve ndërkombëtare edhe gjatë muajit të parë të vitit 2008.

Gjatë këtij muaji, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar me shumicë votash një rezolutë për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Në këtë rezolutë, nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara kërkohet që të kapërcehen dallimet, dhe që të imponohet zgjidhja për statusin e Kosovës, pasi mundësitë për kompromis janë shtruar, ndërsa statusi i pazgjidhur ndikon në jostabilitetin e gjithë rajonit.

Ndërkohë, për gjendjen në Kosovë është diskutuar edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në Nju Jork. Kosova ka qenë temë diskutimi edhe në takimin e zyrtarëve të 10 vendeve të Mesdheut që është mbajtur në Nikozi të Qipros, si dhe në Lubjanë ku janë takuar pjesa evropiane e Grupit të Kontaktit...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit janar 2008.



Ban Ki Moon

(1 janar) Ban Ki-Moon: "Status quo nuk do jetë e qëndrueshme"

Nju Jork – "Status quo-ja me siguri nuk do jetë e qëndrueshme. Nëse ngecja vazhdon, ngjarjet në teren mund t'i vënë në rrezik arritjet e Kombeve të Bashkuara", ka thënë Sekretari i përgjithshëm i OKB-së Ban Ki-Moon, në një raport për Këshillin e Sigurimit

it, duke nënvizuar se jostabiliteti në Kosovë mund të shtrihet më gjerë në rajon.

Në raport, Ban Ki-Moon u bën thirrje serbëve dhe shqiptarëve që t'u mbeten besnikë zotimeve për t'u përmbajtur nga dhuna.

(2 janar) Ahtisaari i dëshpëruar me mungesën e përparimit në Këshillin e Sigurimit

Helsinki - I dërguari i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari i ka thënë agjencisë Reuters se beson se statusi i Kosovës do të përcaktohet në tre muajt e parë të vitit 2008. Ahtisaari ka thënë se nuk ishte i dëshpëruar me mungesën e përparimit në Këshillin e Sigurimit, meqë, sipas tij "asgjë befasuese nuk ka ndodhur".



David Miliband

(4 janar) Miliband: Prioritet zgjidhja e drejtë dhe afatgjate për Kosovën

Londër - Gjetja e një zgjidhje të drejtë dhe afatgjate për Kosovën është e para në listën e pesë zhvillimeve që nevojitet të ndodhin në 2008-ën, e hartuar nga ministri i jashtëm britanik, David Miliband

(7 janar) Jansha: Kosova nuk do të jetë 'totalisht e pavarur'

Lubjanë – "Varshmëria e Kosovës nga ndihma e BE-së nënkupton se Kosova nuk do të jetë 'totalisht e pavarur'", ka deklaruar kryeministri i Sllovenisë Janez Jansha, që aktualisht e kryesor presidencën e radhës së Bashkimit Evropian duke vlerësuar se Bosnja është kërcënim "më serioz" për stabilitetin në Ballkan se Kosova.

(9 janar) Erler: Mund të krijohet një vakuum i rrezikshëm...

Berlin - Gjermania druan se mund të krijohet një vakuum i rrezikshëm nëse BE-ja nuk lëviz shpejt në njohjen e shpalljes së pritshme të pavarësisë së Kosovës në

muajin shkurt, ka thënë zëvendësministri i Jashtëm gjerman Gernot Erler.

(10 janar) Jaap de Hoop Scheffer : Nevojitet bashkëpunimi i ngushtë NATO – BE për Kosovën

Bruksel – "Situata në Kosovë mbetet shpërthyes, por askush të mos ushqejë iluzione se do mund të përmbushë qëllimet përmes mjeteve të dhunshme", ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer, duke shtuar se është e nevojshme bashkëpunimi i ngushtë NATO – BE për Kosovën.

(11 janar) NYT: SHBA-ja dhe Gjermania janë pajtuar që ta njohin shtetin e Kosovës

Uashington - Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania janë pajtuar që ta njohin Kosovën pasi ajo të shpallë pavarësinë, dhe t'i bëjnë thirrje pjesës tjetër të Evropës që ta ndjekë shembullin e tyre, ka shkruar e përditshmja e Nju Jorkut "Neë York Times"(NYT). Kjo gazetë ka cituar zyrtarë të lartë evropianë të kenë thënë se në një bisedë që presidenti George Bush dhe kancelarja Angela Merkel së fundi kanë zhvilluar rreth Kosovës, ata janë pajtuar se njohja e Kosovës është jetësore për të stabilizuar Ballkanin Perëndimor.



(12 janar) Casey: Uashingtoni edhe më tutje mbështet planin e Ahtisaarit

Uashington - Politika e Shteteve të Bashkuara është e qartë dhe konsistente dhe Uashingtoni edhe më tutje mbështet planin e Martti Ahtisaarit, me pavarësi të mbikëqyruar për Kosovës, ka thënë zëdhënësi i departamentit amerikan të shtetit, Tom Casey, duke mohuar se ka njohuri për ekzistimin e një marrëveshjeje për aksion-

in e përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë lidhur me këtë çështje.



Nicolas Sarkozy

(16 janar) Këshilli i Sigurimit i OKB-së diskuton për gjendjen në Kosovë

Nju Jork - Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka diskutuar për gjendjen në Kosovë. Në pjesën e parë të takimit, ka folur presidenti i Serbisë Boris Tadiç, ndërsa në pjesën e mbyllur, ku është paraqitur raporti i rregullt tre mujor nga shefi i UNMIK-ut, Joachim Rycker, ka folur edhe kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi.

(17 janar) 10 vende të Mesdheut diskutojnë për Kosovën

Nikozi - Zyrtarët e lartë të 10 vendeve të Mesdheut, që janë anëtare të Bashkimit Evropian, janë tubuar në një konferencë dyditëshe për të diskutuar për statusin e Kosovës, për Lindjen e Mesme dhe për imigrimin ilegal.

(18 janar) Sarkozy: Status quo-ja nuk është më opsion i qëndrueshëm

Paris- Presidenti i Francës Nicolas Sarkozy ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që "fuqishëm dhe i bashkuar të mbështesë zgjidhjen e vetme të zbatueshme për Kosovën", njoftoi AFP. "Status quo-ja nuk është më opsion i qëndrueshëm, ndërsa të gjitha mundësitë për bisedime janë shteruar", dhe nuk kanë dhënë kurrfarë rezultati, ka thënë Sarkozy në një takim tradicional me përfaqësuesit e korit diplomatik në Paris.

(19 janar) Pjesa evropiane e Grupit të Kontaktit diskuton për Kosovën

Lubjanë - Në Bërdo afër Kranjtit në Slloveni është mbajtur mbledhja e pjesës evropiane të Grupit të Kontaktit për Kosovën. Në takimin joformal pos përfaqësuesit të Sllovenisë, kryesuese e BE-së, kanë marrë pjesë edhe zyrtarët e lartë, Javier Solana

dhe Oli Rehn si dhe ministrat e Jashtëm të Britanisë së Madhe Miliband, të Gjermanisë Shtajnmajer, të Francës Kushner dhe të Italisë D'Alema.

(22 janar) Rezolutë për Kosovën në Këshillin e Evropës

Strasburg - sambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi me 96 vota për, 48 kundër dhe 24 abstenime rezolutën për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Në këtë rezolutë, nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara kërkohet që të kapërcehen dallimet dhe që të imponohet zgjidhja për statusin e Kosovës, pasi mundësitë për kompromis janë shteruar, ndërsa statusi i pazgjidhur ndikon në jostabilitetin e gjithë rajonit.

(23 janar) Rice: Jemi të bindur se statusi i Kosovës duhet të zgjidhet

Cyrih- "Jemi fuqishëm të bindur se statusi i Kosovës duhet të zgjidhet", ka thënë sekretarja amerikane e shtetit, Condoleezza Rice, duke shtuar se "me përpjekjet e Ahtisaarit është arritur mënyra që kjo çështje të zgjidhet në mënyrën më të qetë të mundshme". Këto komente zonja Rice i ka bërë pas takimit me ministren e jashtme zvicerane, Micheline Calmy-Rey.



Micheline Calmy-Rey

(24 janar) MJGJ: Rezoluta 1244 nuk e ndalon shpalljen e njëanshme të pavarësisë

Berlin- Rezoluta 1244 nuk e ndalon shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës dhe as njohjen e shtetësisë së Kosovës nga vendet tjera, thuhet në një raport ekspertësh juridik që e ka porositur ministria e Jashtme në Berlin.

Ekspertët gjermanë kanë vlerësuar se dispozita në preambulën e rezolutës, ku kërkohet ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë (tash Serbisë), ka të bëjë vetëm me gjendjen kalimtare të krijuar me rezolutën 1244.



OKB

(25 janar) Ban Ki-Moon i shqetësuar për zhvillimet në Kosovë

Lubjanë- Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon ka paralajmëruar për rreziqet nga bllokimet rreth statusit të Kosovës. "Nëse kjo bllokadë vazhdon, situata mund të marrë rrjedhën e vet. Kjo do të ishte shumë e rrezikshme", ka thënë Ban Ki-Moon pas takimit me kryeministrin e Sllovenisë, Janez Jansha.

(27 janar) Parvanov: Bullgaria nuk do ta njoh menjëherë pavarësinë e Kosovës

Sofje- "Bullgaria nuk do të jetë në mesin e vendeve që do ta njohin menjëherë pavarësinë e Kosovës", ka thënë presidenti bullgar Georgi Parvanov në një konferencë për shtyp një vit pas mandatit të dytë presidencial. "Ne dëshirojmë që Bashkimi Evropian të miratojë një qëndrim të përbashkët në Ballkan. Kemi nevojë për një zgjidhje që garanton stabilitet për tërë rajonin, përfshirë edhe marrëdhëniet e mira mes fqinjëve", ka thënë Parvanov.

(28 janar) Ban Ki Moon: Vendosja e misionit të BE-së në Kosovë është çështje e evropianëve

Bratisllavë - Vendosja e ardhshme e misionit të BE-së në Kosovë është "çështje e evropianëve", ndërsa BE-ja duhet ta pranojë përgjegjësinë kryesore për këtë, ka thënë sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki Moon gjatë qëndrimit të tij në Bratisllavë.

(29 janar) Rusia kundërshton dërgimin e misionit të BE-së në Kosovë

Moskë- Rusia i ka kundërshtuar planet e Bashkimit Evropian për dërgimin e misionit në Kosovë, duke thënë se një dërgim i tillë kërkon miratim specifik në KS të OKB-së. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Mikhail Kamynin i ka tërhequr vërejtjen BE-së që të mos përpiqet ta anashkalojë Këshillin e Sigurimit. ■



Kosova shpalli pava

+ Dita e 17 shkurtit do të mbetet ditë e shënuar në historinë e Kosovës dhe e paharruar në mendjen e qytetarëve të saj. 109 deputetë, në një seancë të jashtëzakonshme e kanë shpallur Kosovën shtet të pavarur. +



Kryeministri Hashim Thaçi, në konferencën për media njofton se është dorëzuar kërkesa për të mbajtur seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, ku në rend dite do të jenë miratimi i deklaratës së pavarësisë dhe simboleve të Kosovës.



Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e zgjeruar ku morën pjesë edhe shefat e grupeve parlamentare, ka miratuar njëzëri kërkesën për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme në ora 15.00

Kuvendi i Kosovës ka filluar seancën për shpalljen e pavarësisë



Kryeministri Thaçi, gjatë seancës solemne të Kuvendit të Kosovës, paraqet Deklaratën për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



109 deputetët e pranishëm në seancë votojnë për shpalljen e pavarësisë dhe e nënshkruajnë Deklaratën për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.



Deputetët e Kuvendit të Kosovës gjatë seancës solemne kanë miratuar flamurin e shtetit të Kosovës. Flamuri ka fushën e kaltër, me hartën e Kosovës në mes me ngjyrë të arit, dhe gjashtë yje mbi hartë me ngjyrë të bardhë.

rësinë



Vetëm pak kohë para se Kosova ta shpall pavarësinë, qindra-mijëra qytetarë kanë vërshuar rrugët e Prishtinës nga të gjitha anët e Kosovës, viseve të tjera etnike shqiptare dhe diaspora, që të presin shpalljen e pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës.



Presidenti Fatmir Sejdiu dhe kryeministri Hashim Thaçi në orët e mbrëmjes para Pallatit të Rinisë në Prishtinë, zbuluan obeliskun "Newborn" ("I porsalinduri")



Për dy orë rresht këngëtarët më të mirë janë paraqitur për të kënduar para qytetarëve të shumtë që kanë festuar deri në orët e vona të natës.



Pas orës 23.00, për disa minuta radhazi nga të katër anët e Prishtinës janë hedhur gjashtë tonë fishekzjarrë, duke krijuar pamje të bukura në qiellin e kryeqytetit të shtetit më të ri në botë.



Sejdiu-Thaçi urojnë qytetarët për Pavarësinë e Kosovës

Përgatitën:

Gëzim QERIMI & Osman D. GASHI



SHËN VALENTINI MISTERIOZ



Bujar SEJDIU

14 Shkurti apo Shën Valentini është një festë e shpifur në bazë të legjendave të ndryshme që kanë zanafillën e tyre në paganizëm. Vet fakti që legjendat apo mitet për burimin apo prejardhjen e kësaj feste dallojnë, e bëjnë këtë festë edhe më të pavlerë, dhe ju tregojnë atyre që kanë logjikë që të gjithë ata që e festojnë dhe e urojnë këtë festë janë duke jetuar në mite dhe legjenda, pra janë larg së vërtetës dhe realitetit.

Sidoqoftë, për çdo vit më 14 shkurt, pothuajse në të gjitha vendet e botës shohim lodra, lule, festime dhe shkëmbime dhuratash të ndryshme mes atyre që duhen “sinqerisht”, dhe të gjitha këto në emër të të Shenjtit Valentini!

Kush është ky shenjtor misterioz ?

Historia e Ditës së Valentinit, është e mbështjellë me misteriozitet. E dimë që shkurti për kohë të gjatë ka qenë muaji i romancës që përmban gjurmë nga tradita e krishtere dhe antiko-romake. Por kush ishte Valentini i Shenjtë dhe çka e lidhë atë me këtë rit antik?

Sot Kisha Katolike numëron së paku tre shenjtorë të ndryshëm të quajtur Valentine apo Valentinus, të gjithë të martirizuar. Sidoqoftë, edhe pse ekzistojnë përralla të ndryshme lidhur me këtë, historia që fshihet pas kësaj feste të shpikur, imorale dhe pagane nuk dihet nga shumë njerëz.

Më poshtë po paraqesim disa versione të saj:

- Thuhet se Greqia pagane kishte zakon të festojë 15 shkurtin çdo vit si festë pranverore. Në atë kohë krishterimi ishte diçka e re për këtë pjesë të planetit. Perandori Claudius II ua kishte ndaluar martesën ushtarëve të tij. Valentini, një klerik i krishterë sfidoi komandën e tij dhe vazhdoi t'i lidhte të dashuruarit sekret me martesë sekrete. Shumë shpejt ishte zbuluar nga pushteti dhe ishte bur-

gosur deri në vdekje. Përderisa ishte në burg ai u dashurua me vajzën e rojës së burgut, por edhe kjo ishte sekrete pasi që krishterimi ua ndalonte klerikëve të martohen, dhe kështu ata detyroheshin të kishin afëra të fshehta (imorale) me femra. Por pasi që ai ende qëndronte në krishterizëm, populli i mbylli sytë karshi “kriminalit” të tij që kishte rënë në dashuri. Perandori i ofroi falje dhe i premtoi që ta bënte njeri të afërm të tij dhe ta martonte me vajzën e tij, me kusht që ky të hiqte dorë nga krishterimi. Mirëpo Valentini zgjodhi krishterimin dhe u ekzekutua me 14 shkurt të vitit 270, një natë para festës tradicionale pranverore. Qysh nga ajo kohë, kjo ditë ishte quajtur “Festa e Priftit Valentini”.

Një prej miteve më të përhapura dhe më të “besueshme”

Pas përhapjes së krishterimit në Evropë, dita e 14 shkurtit ishte riemëruar “Dita e Valentinit” si shenjë e përkujtimit për të pasi që, siç thuhet, ai kishte sakrifikuar veten e tij për krishterimin dhe ishte kujdesur për ata që janë në dashuri.



Kjo është njëra prej miteve më të përhapura dhe më të “besueshme” nga njerëzit. Në anën tjetër qarkullojnë edhe versione të tjera lidhur me këtë ditë. Disa thonë që kisha e krishtere mund të ketë vendosur që ta festojë këtë ditë në përpjekje për ta “krishterizuar” festivalin

pagan të quajtur “Lupercalia Festival”. Përderisa disa të tjerë besojnë që kjo kishte mbetur si festë, pasi që në Romën Antike, muaji Shkurt ishte fillimi zyrtar i Pranverës që konsideroj kohë për spastrim.

Më vonë, në disa vende të Evropës si në Angli dhe Francë, ishte besuar se 14 Shkurti ishte fillimi i sezonës së shumimit të zogjve, dhe kjo kishte bërë që mesi i Shkurtit, Dita e Valentinit, të konsiderohej dita e dashurisë dhe e romancës.

Kështu, gradualisht 14 shkurti u shndërrua në një ditë shkëmbimi të mesazheve të dashurisë dhe Valentini i Shenjtë u bë i shenjti i të dashuruarve.

Kjo ishte historia që fshihet pas kësaj feste. Fatkeqësisht shumë të rinj e të reja kanë rënë në kthetrat e këtij mashtrimi, dhe e gjithë kjo është për shkak të besimit të tyre të dobët, injorancës fetare, pavëmendshmërisë dhe mungesës së udhëzimit nga dijetarët dhe njerëzit e moralshëm. Si pasojë e kësaj, rinisë injorante i janë mbyllur sytë në festimin e kësaj feste.

Ndër manifestimet e kësaj feste janë dhënia e luleve të kuqe, veshja me ngjyrë të kuqe, shkëmbimi i përhëndetjeve të veçanta, kartolinat dhe dhuratat. Kjo është ditë në të cilën secilit “duhet” t'i kujtohet i dashuri apo e dashura. Aq shumë është rrënjësuar kjo festë në kulturën perëndimore, dhe po përhapet në të gjithë botën, sa që kujtimi i kësaj dite dhe festimi i saj është bërë shenjë e “dashurisë së vërtetë dhe të sinqertë”, dhe nuk është aspak çudi që nëse dikush e harron këtë ditë, të konsiderohet si “jo i sinqertë” dhe “jo i vërtetë” në dashurinë e tij apo të saj!

Pra, si mund të besojmë që Dita e Valentinit ka ndonjë përfitim për njerëzimin?! E vërteta është që kjo ditë është një thirrje më shumë për “tolerancë” dhe imoralitet, dhe stimulim për lidhjet apo aferat e ndaluara dhe të pamoralshme.

Vërtetë një burrë apo grua që sinqerisht e dashuron bashkëshortin apo bashkëshorten e vet nuk ka nevojë për këtë ditë që ta kujtojë dashurinë e tij apo të saj. Ata e shprehin dashurinë e tyre të sinqertë gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha rastet. ■



Diplomacia e Detantës dhe ndikimi i saj në përfundimin e luftës së ftohtë

Arsyet kryesore pse erdhi deri të Detanta duket se ishin të lidhura ngushtë me “ekuilibrin nuklear” të SHBA-së dhe BRSS-së. Ato kishin kuptuar se lufta ishte bërë e pakuptimtë për shkak të rezervave shumë të mëdha nukleare që posedonin...



Arben MUHAMETI

dhe të prosperonte në planin ekonomik që ishte shumë mbropa ndaj Perëndimit. Përveç këtyre arsyeve të përbashkëta, natyrisht se të dy palët kishin edhe arsye të veçanta pse promovonin Detantën.

SHBA-ja në fakt kishte parashikuar në hollësi përfitimet në planin gjeostratejik nga një politikë e tillë shtendosje që ajo e quante “struktura e paqes”. Argumenti i presidentit Nikson ishte se “në një botë shumëpolëshe, ndryshimet duhet të bëheshin nëpërmjet evoluimit”. Gjithashtu Niksoni i cili e kishte përqendruar të tërë politiken e jashtme në duart e tij dhe merrej me shumë entuziazëm më të, Detantën e shikonte si një element taktik në luftën afatgjatë gjeopolitike.

Është tepër interesante të theksohet se administrata e Niksonit mendonte se pikërisht Detanta do të shpërbente Bashkimin Sovjetik (BS). Argumentet e tyre fokusoheshin në faktin se me privimin e BS nga konfliktet rajonale, nga gara e armatimeve, ose më mirë të themi të mbeturit pa partner në këto fusha, do ta shtynte atë ti shikonte problemet e brendshme, të prekte realitetin e popullit rus që ishte në gjendje të rëndë ekonomike, e në anën tjetër ajo politikë mbahej pikërisht duke e “luftuar imperializmin amerikan”. Duke e privuar nga kjo “kënaqësi”, BS-ja do të përballlej me problemet e rënda dhe të grumbulluara që përpiqej ti shmangte! Mirëpo, kritikuesit më të ashpër të Detantës ishin pikërisht në SHBA. Argumentet e tyre ishin përqendruar në atë se SHBA-të po e dorëzojnë luftën në prag të triumfit, në atë se po sillen me shumë butësi dhe besim me rusët, ata nuk besonin në sinqeritetin e rusëve...

Bashkimi Sovjetik vihet në grackë...

Në praktiken sovjetike ky term përmbledh subversionin, propagandën, kërcënimet politike, veprimet e spiunazhit. Madje të tjerë kritikues liberalë, neoliberalë dhe konservatorë theksonin se Detantë për Bashkimin Sovjetik do të thotë dobësi e SHBA-së;

minim i NATO-s; intensifikim i luftës ideologjike; tërheqje e forcave amerikane nga Evropa...

Megjithatë shikuar nga perspektiva e sotme mund të konkludojmë se diplomacia e Detantës ishte e suksesshme dhe vuri në grackë Bashkimin sovjetik, i cili nuk ishte as i fuqishëm as aq dinamik sa të luante rolin e një superfuqie që do të vendoste rendin në botë e aq më pak paqen e stabilitetin.

Ish-presidenti amerikan Ronald Regani gjatë mandatit të vet kishte marrë përsipër t’u shpjegonte udhëheqësve sovjetik se filozofia komuniste ishte e gabuar, dhe posa të sqaroheshin konceptet e gabuara mbi natyrën e vërtetë të Amerikës, do të vinte menjëherë një epokë pajtimi. Në këtë kohë shumica e fitoreve sovjetike të viteve ’70-të u përmbysen. Zhvillimet ushtarake që ishin në rënie ndihmuan edhe në rënien e entuziazmit ideologjik.

Në kohën kur BS-ja po humbte terren përditë e më tepër, SHBA-ja nëpërmjet Presidentit Regan kishte intensifikuar përpjekjet e veta në fushën e mbrojtjes, duke dislokuar raketat amerikane me rreze veprimi të mesme në Evropë si dhe Iniciativa strategjike për mbrojtjen. Siç konstaton edhe ish-sekretari i SHBA-së Kisinxher, “lufta e ftohtë kishte filluar në një kohë, kur Amerika priste një periudhë paqeje dhe përfundoi në një moment, kur Amerika po përgatitej për t’i bërë ballë një periudhe të re konflikti të zgjatur”.

Mund të konkludojmë se ishte pikërisht Detanta ajo që solli shpejtimin e përfundimit të Luftës së ftohtë, sepse ajo luftë mbante gjallë BS-në duke i dhënë mundësinë për tu konfrontuar me Perëndimin dhe për të shtyrë Botën drejt një konflikti të ri të panevojshëm.

Tërheqja taktike e SHBA-së e veshur me petkun e Detantës mundësoi një përfundim paqësor të shpërbërjes së bllokut lindor, rikonfigurimit të interesave strategjike dhe përcaktimit të një rendi të ri botëror. ■

Detanta, në diplomaci nënkupton një shtendosje të marrëdhënive ndërmjet blloqeve Lindje-Perëndim. Politika e Detantës nuk filloi papritmas, ajo ishte produkt i një përplasje të vazhdueshme, i konfrontimeve ideologjike të pandërprera, i një varg luftërash rajonale, ku padyshim sponzorizues ishin dy superfuqitë e mëdha.

Situata politike që ekzistonte në atë kohë ishte tepër e ndërlikuar. Amerikanaët nuk e kishin idenë se si do të dilnin nga Vietnami, përkeqësim dramatik i konfliktit arabo-izraelit, rritje befasese e influences sovjetike në Lindjen e Mesme, ndërtimi i murit të Berlinit, afrimi i De Golit me sovjetiket, antagonizmat shoqërore në SHBA që ishin në kulmin e tyre, si dhe një varg faktorësh tjerë ishin indikacione të qarta, se situata ndërkombëtare po merrte përpjesëtime shqetësuese dhe të pakontrolluara.

Arsyet kryesore pse erdhi deri te Detanta duket se ishin të lidhura ngushtë me “ekuilibrin nuklear” të SHBA-së dhe BRSS-së. Ato kishin kuptuar se lufta ishte bërë e pakuptimtë për shkak të rezervave shumë të mëdha nukleare që posedonin, ndërkohë që do ta kursenin veten nga konfliktet pandërprera rajonale dhe do të ulnin pakënaqësitë gjithnjë e në rritje brenda popullit të tyre. Sipas disa statistikave pjesa e shpenzimeve për mbrojtjen arrinte gati gjysmën e bruto të ardhurave kombëtare të secilës prej tyre. Kështu, ngarkimi i madh popullsisë në SHBA, shkaktoi thellimin e kundërthënieve shoqërore me tendenca të shndërrohen në luftë të pakompromisë klasore.

Ndërkaq për BRSS ishin dërmuese këto shpenzime, absolutisht nuk ishte në gjendje të dilte nga kriza ekonomike

Shtrembërim i historisë

Nuk ka dyshim se Muhammedi s.a.v.s. i kishte dërguar letra mbretërve dhe perandorëve të kohës. Këtë e vërteton historia islame me argumente faktike. Është për të ardhur keq se bota krishtere vetëm gjërat që nuk e rëndojnë i beson, ndërsa të gjitha ato ngjarje në të cilat ka dorë të drejtpërdrejt në to është injoruese



**Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI**

Që kur lindi islami, bota e krishterë humbi dokumentacionin, është për t'u habitur se si kjo ndodhi! Nëse perëndimorët posedojnë dokumentacionin e duhur të historisë para shfaqjes së islamit, atëherë cila është arsyeja që prej lindjes së islamit të thonë se mesjeta është e errët për ta. "Pas lulëzimit të jetës letrare në kohën e Justinianit, nga shekulli VII-të, fillon një periudhë e varfër letrare, që për këtë arsye quhet shpesh herë si periudhë e errët e Bizantit. Në fakt, asnjë epokë e historisë bizantine nuk është e mangët në burime sa shekujt e VII e VIII, që fillojnë më së pari me vitet e sundimit të Heraklitit".

Pikërisht, me Heraklin fillon fshehja e dokumentacionit! Perandoria bizantine kishte një kulturë të lartë, atyre nuk ju mungonte asgjë, saqë të mos ishin në gjendje të shkruanin mbi ndodhitë e botës që i rrethonte. Jam thëllësisht i bindur se shumëçka do të ishte më ndryshe në botë, sikur të mos fshiheshin ngjarjet që kanë ndodhur gjatë periudhës së lulëzimit të islamit. Ky dokumentacion është ndër myslimanët, por që do, kur atë edhe më tutje e injorojnë perën-

dimorët. Këto të dhëna nuk mësohen në shkollat perëndimore, sepse akoma nuk besojnë se myslimanët janë fetar dhe atë të devotshëm. Mjerisht këtë devotshmëri e krahasojnë me dhunën dhe terrorizmin.

Këtu fillon edhe ndarja e madhe ndërnjerëzore. E vërteta në këtë botë mbase nuk do të mësohet kurrë, por, ajo do të dalë një ditë (Ditën e Gjykimit). Kemi studiues të paanshëm të historisë nga bota e krishterë që herë pas here nxjerrin disa të dhëna të cilat na japin kurajë të dimë se ç'kishte ndodhur. Shumë studiues për të mos thënë të gjithë studiuesit perëndimor nuk i pranojnë letrat (mesazhet) e Muhammedit s.a.v.s. si ngjarje të vërteta. Sikur një studiues jo mysliman t'i futej hulumtimit dhe analizave rreth shkaqeve të njëmendta të luftërave do të mësonte se mesazhet e Pejgamberit s.a.v.s. ishin ngjarje të sakta.

Myslimanëve ju bën përshtypje të dinë se çfarë kishte ndodhur në fakt me pushtetin e Heraklitit. Sipas burimeve islame ai ishte i gatshëm ta pranonte islamin, bile ai ka mundur të shpallte islamin si fe, sepse them se burim i mobilizimit të tij kundër persëve ishte Kur'ani. Ndërsa burimet bizantine e fshehin këtë realitet. Nëse ai, vërtetë kishte deklaruar islamin si fenë e tij, myslimanët nuk e dimë, por, është e vërtetë se prej këtu ka filluar përçarja e madhe midis të krishterëve dhe urrejtja ndaj islamit dhe myslimanëve.

Ishte paradoksale, që i tërë mundi i perandorisë bizante të shkonte kot. Pas disa vjet luftime të përgjakshme kundër persëve, fitoren e tyre do ta gëzonin myslimanët! Islami po triumfonte, dhe këtë Herakli e kuptoi, por, si duket aparaturo e oborrit perandorak kishte konstatuar se duhet akoma t'i qëndronin karshi myslimanëve (të pa feve). Sikur të krishterët mos t'i konsideronin myslimanët të pa fe, bota do të kishte një pamje krejtësisht tjetër.

Rasti më i mirë për të sunduar priftëria në vend të perandorit të tyre, ishte martesja e tij me Martinën. Gruaja e parë e Heraklitit, Fabia-Eudokia kishte vdekur më 612 pasi i kishte lindur atij dy fëmijë. Ndërsa ai u martua me Martinën e cila ishte mbesa e tij. Kjo martesë shkaktoi skandal në Kostandinopojë. Në shekullin e VII-të nuk ishte gjë e madhe (mëkat) të martohej një mashkull me një femër nëse ishin të afërm të gjakut. Por, Kostandinopoja këtë bashkim e kishte cilësuar të shëmtuar. Meqenëse populli e shikonte me urrejtje Martinën, kisha shfrytëzoi këtë rast dhe qëndroi kundër vlerësimeve që Perandori kishte ndaj islamit. Martina i kishte lindur Heraklitit nëntë fëmijë, katër prej tyre i kishin vdekur duke qenë foshnje, ndërsa dy prej tyre kishin lindur të deformuar. Kisha dhe populli këtë tragjedi të Heraklitit, e komentonin si shenjë të zemërimit hyjnor. Sipas kishës martesja me të afërmit në gjak është kundër rregullave Kanonike!? Sikur kjo t'ishte e vërtetë, atëherë, bota do të duhej t'ishte me shumë njerëz ose të paktën gjysma prej tyre të deformuar, sepse edhe në ditët tona të sotme shumë popuj martohej me të afërmit e tyre.

Libri historik i Ostrogorsky-it na jep një fakt shumë interesant. Ai thotë: "Herakli i cili kishte udhëhequr vetë të gjitha fushatat kundër Persisë, në luftën me arabët nuk mori pjesë aktive. Në fillim u përpoq të drejtojë veprimet luftarake nga Antioka, por pas betejës së





Jerusemit mendoi që tashmë çdo gjë kishte marrë fund dhe u tërhoq. Përpara syve po i copëtohej krejt vepra e jetës së tij. Lufta heroike kundër Persisë dukej të kishte qenë e kotë: duke rrëzuar perandorinë persiane vetëm se i kishte përgatitur rrugën arabëve. Në Tokën e Shenjtë, që mendonte se ia kishte rikthyer krishterimit, tani sundonin sërish të pabesët” (faqe 87).

Pas kësaj humbjeje të madhe ai u godit rëndë, kaloi në çmenduri!? Për të thuhet se, kur iu afrua Bosforit, ai nuk e duronte pamjen e detit dhe u detyruan që me anë të varkave të mbushura me rërë e me gjethe të formonin një urë, enkas për të, derisa ta kalonte atë.

Le t'i kthehemi letrave të Pejgamberit s.a.v.s. i cili ua dërgoi perandorëve dhe mbretërve të kohës. Tani do të përpiqem të argumentoj mundësinë e datave gjegjësisht viteve të mesazheve dhe ngjarjeve që ndodhën në atë kohë.

Fillimisht - mrekullia e Kur'anit

Kur'ani kishte filluar të shpallet nga viti 610 e deri në vitin 632 të erës sonë. Persianët dhe bizantinët herë pas here luftonin midis tyre, ishte e pa mundur t'i qëndronin besnik marrëveshjeve të paqes që nënshkruanin midis vete. Sa herë që në fron vinte një perandor i ri, marrëveshjet në të shumtën e rasteve thyheshin. Në kohën kur në fron erdhi Dastagerdi (Kisra, është titull perandorak pers), filluan sërish luftimet me bizantinët. Këto luftime u zhvilluan nga viti 611-të, vit në të cilin ra në duart e

persëve Kajseri (Cezaria), ndërsa në vitin 614 ra Jerusemi, qyteti i shenjtë i krishterëve. Ky vit konsiderohet si viti më i rëndë i gjithë sundimit të perandorisë bizantine, sepse në këtë vend u dorëzua edhe Kryqi i Shenjtë. Pra, Bizanti u detyrua t'i paguajë shtetit Pers tribute të mëdha, gjë që e rëndonin edhe më shumë ringritjen e serishme.

Persët arritën në brigjet e Bosforit në vitin 615-të, luftime sporadike u zhvilluan deri në vitin 619-të brenda territorit të Azisë së vogël. Ndërsa në anën tjetër të perandorisë në gadishullin Ballkanik avarët dhe sllavët pamëshirshëm sulmuan këtë perandori të fuqishme. Luftimet mbaruan me paraqitjen e dy ushtrive fitimtare në Bosfor në vitin 619-të.

Kur'ani, kishte informuar besimtarët në suren Rum (romakët) se persët përfundimisht i mundën romakët, por ai, gjithashtu i sqaroi besimtarët duke ju thënë se romakët për një kohë të


shkurtër, ose më saktë për Bidëi sinin do t'i rikthejnë tokat e tyre.

Ky informacion i Kur'anit ishte bërë për arsye besimi. Kush prej tyre besonte e kush nuk besonte. Kishte prej tyre që kishin vu baste për fitoren e serishme të bizantinëve. Kështu Ebu Bekri kishte vu bast me një shok të tijin jobesimtarë. Sipas Ebu Bekrit bizantinët do të fitonin brenda nëntë vjetëve. Arabët fjalën 'bidëi sinin' e kuptonin si vite tek, nga një deri në nëntë. 'Bidëi sinin', asnjëherë nuk kalonte në numrat dyshifror, pra mbi dhjetë vjet.

Kështu edhe ndodhi, Herakli menjëherë në vitin 619-të lidhi marrëveshje me avarët për mossulm të serishëm ndaj Perandorisë Bizantine, derisa ajo do t'iu paguante atyre tribute të mëdha, ndërkohë Herakli po përgatitej të sulmonte persianët.

Sipas burimeve islame, Herakliu u frymëzua nga thënia e Kur'anit dhe për tri vjet rresht arriti të konsolidojë një ushtri të fuqishme. Në vitin 622 (Viti i Ri i Hixhretit tek myslimanët), Herakli arriti të futet në disa territore të lira dhe në pranverën e vitit 623 çliroi disa provinca të Armenisë. Kështu vazhdoi, fitore pas fitoreje deri në vitin 627-të. Në pranverën e vitit 628-të, Herakli po përgatiste ofensivën e madhe me të cilën do ta çrrënjoste perandorinë persiane një herë e mirë.

Herakli, nuk hyri në brendi të këtij territori, sepse Persia u kaplue nga trazira të mëdha të cilat përfunduan me vrasjen e Dastagerdit. Djali tij Shirevahi (burimet bizantine Shiroe) u shpall mbret i Persisë. Ky ia dorëzoi Kryqin e Shenjtë dhe u detyrua t'i paguajë Bizantit tribute dhe kështu lufta midis këtyre dy perandorive përfundoi. ■



Pamje nga ngushtica e Bosforit

Letër e hapur për kolegët e mi hoxhallarë

Të fillojmë të shkruajmë hapur për çështjet që na preokupojnë

Muhamed Jusufi-KAJOLLI

Selamun Alejkum ve Rahmetullahi ve Berekatuhu,

Tani mundësitë i kemi dhe, ne polemikat tona duhet t'i këmbëjmë me letra të hapura. Padyshim, kjo do të ndihmonte kauzën tonë, si atë fetare, ashtu edhe atë kombëtare. Duke qëndruar në nivelin e duhur fetar, do të ndihmohet populli për të kuptuar më saktë rrugëtimin tonë të gjatë. Mendoj se të gjithë jemi të pajtimit që bisedimet e odave t'ia lëmë të kaluarës.

Të nderuar kolegë,

Ajo që më shtyri të shkruaj këtë letër të hapur është sjellja e një hoxhe nga Tetova, i cili siç dukej mbivlerësonte veten ndaj të tjerëve me njohuri fetare! Në fakt ai nuk e theksoi këtë me gojën e tij, por, kështu e vlerësoi një numër i vogël individësh që u prezantuan në atë bashkëbisedë. Toni i fjalëve të tij, si dhe përgjigjet e tij me kundërpyetje dhe mohimin e gjërave që i paraqiste më vrazhdësi. Nga mënyra e sjelljeve të tij dukej imponues në mendime prandaj, këtë publikim nuk e bëj për ta identifikuar personin në fjalë, por, mundohem t'i tregoj atij dhe të tjerëve sikur ai, nëse ka në mesin tonë që të kenë kujdes dhe të tregohen të hapur gjatë polemikave më të gjithë bashkëfolësit pranë tyre.

Kështu, polemika me letra të hapura do të ishte mënyra më e mirë dhe më dobi-prurëse se sa llomotitjet nëpër oda. Kjo e fundit krijon demagogë të shumtë, ndërsa ne nuk e kemi luksin dhe nevojën e tyre, prandaj të fillojmë shkruajmë hapur për çështjet që na preokupojnë.

Të nderuar dhe shumë të respektuar kolegë,

Shqiptarët në përgjithësi besimin islam kanë filluar ta rinjohin pas viteve tetëdhjeta të shekullit të XX-të dhe atë, falë përkthimeve të Kur'ani Kerimit dhe më pastaj librave të tjerë që pasuan. Myslimanët autokton të Ballkanit për arsye të njohura his-

torike u shkëputën nga trunghi i shteteve me shumicë myslimane. Pas shtatëdhjetë vitesh arritën të njohin sërish këtë trunq, por nga një kënd tjetër. Jo pse tani i përkasin një feje tjetër, por për shkak se metodologjia e të mësuarit është më ndryshe. Myslimanët e kësaj pjese të botës nuk e kanë trashëguar traditën fetare pa ndërprerje sikur vendet tjera islame, prandaj edhe pyetjet i kanë më ndryshe. Jemi dëshmitarë, kur disa hoxhallarë injorojnë pyetësit, por kjo vjen si rezultat i sjelljeve të liga dhe mosnjohjes së mirëfilltë të Islamit. Shpeshherë kemi hasur që përgjigjet të janë kuturu dhe të pa baza. Themi se, shumica dërmuese e hoxhallarëve e kuptojnë se çdo të thotë fetva?

Është për të ardhur keq, nëse metodologjia e të mësuarit tonë të tanishëm do t'i rikthehej metodologjisë së vjetër. Jo se e vjetra nuk ishte e mirë, përkundrazi, ajo meriton çdo lëvdatë për të kaluarën tonë. Të parët tanë ishin shumë më të avancuar, krahasuar me popujt të tjerë, para shtatë ose tetë shekujsh, por, kjo kishte stagnuar prej kohësh. Falë ideve dhe strukturave të institucioneve që i kishin projektuar dijetarët e mëdhenj të asaj kohe, shteti mysliman jetoi edhe disa shekuj të tjerë. Ata dijetarë nuk janë fajtor që pasuesit e tyre nuk arritën t'i zgjerojnë akoma më shumë idetë e tyre. Në vend të zgjerimit të ideve, pasuesit e tyre ishin kënaqur me vendimet e marra prej tyre (dijetarëve të mëdhenj të asaj kohe), dhe kishin parapëlqyer që ato të mos zëvendësoheshin me të reja, duke mbyllur dyert e ixhtihadit.

Ky ishte një gabim fatal, sepse me këtë vendim ishin kornizuar idetë ose thënë ndryshe kishin ngulfatur Kur'anin i cili ishte, dhe mbetet Libri i Vetëm Hyjnor. Kur'ani është këshillues dhe udhërrëfyes për mbarë njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit. Nëse këshillat ose vendimet e tij "paskan mbaruar" atëherë ai nuk mbetet më Libër Hyjnor (këshillues dhe udhërrëfyes) i njerëzimit?

Fatmirësisht, sot, shumica dërmuese e dijetarëve bashkëkohorë e kanë kuptuar se duhet të ndryshohet metodologjia, gjithnjë

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

duke mos e ndryshuar esencën, por, kemi ende prej atyre që verbërisht u referohen dijetarëve të hershëm. Këmbëngulja e tillë sjell ndarje, ndërsa kjo sjell përçarjen, dhe në fund sërish në anarki. Vallë, meriton Islami t'i sheh myslimanët e katandisur siç janë sot.

Të nderuar kolegë,

Muhammedi s.a.v.s. ishte njeri si të gjithë ne, ai nuk dallonte nga ne për asgjë, me përjashtim se ai ishte i zgjedhuri i Krijuesit, të cilin e kishte ngarkuar atë që ta informonte njerëzimin për Dritën Hyjnore. E mira gjithmonë do ta ketë përballë të keqen, ky është ligji i Krijuesit, ndërsa kjo e dyta vazhdimisht përpiket që të gjejë zbrazëirat prej nga edhe futet për të njollosur të mirën. Këta të këqij nuk arritën asnjëherë ta njollosin Kur'anin, dhe jam i bindur se asnjëherë nuk do të arrijnë ta njollosin atë, por, këta kanë arritur t'i hutojnë besimtarët e rëndomtë, besa edhe gjysmë hoxhallarët pasi kishin integruar në ummet hadithet falso. Këto ndikuan aq shumë në ummet saqë përmbysën edhe kalifatin. Sot jemi këta që jemi, por duke qenë se të gjithë myslimanët e kanë për detyrë ta përcjellin mesazhin Hyjnor, duhet të kanë kujdes nga këto të ashtuquajturat hadithe, të cilat tërthorazi kanë arritur t'i shfuqizojnë disa ajete Kur'anore në ummetin tonë.

Fatkeqësisht, shumë prej hoxhallarëve nxitojnë në dhënien e fetvave dhe me të marrin mbi supet e veta edhe barrën e të tjerëve. Kisha këshilluar veten time dhe të gjithë ata që merren me thirrjen islame, le të mos nxitojë në dhënien e fetvave, në marrëdhëniet midis njerëzve ose popujve. All-llahu i Lartëmadhëruar në përgjithësi gjërat i ka lënë të hapura. Përderisa shumë gjëra Ai nuk i mbylli, atëherë përse ne duhej t'i mbyllim ato me anë të ashtuquajturave hadithe. Nuk është në kompetencën e askujt t'i shfuqizojë ajetet kur'anore, nëse ndonjë nuk është shfuqizuar prej vetë All-llahut.

All-llahu i Lartëmadhëruar thotë: **Për çdo varg (Kurani) që Ne e shfuqizojmë apo që e bëjmë të harrohet, Ne sjellim ndonjë tjetër më të mirë ose të ngjashëm me të. A nuk e di ti se All-llahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?! (Bekare 106)**

Në përmbyllje të kësaj letre kisha

dëshiruar që në vend se ta hapja polemikën tonë të zhvilluar me mikun tonë nga Tetova, të shtroja pyetjen time me të cilën do ta hapja debatin shkallë pas shkalle. Do të ishte shumë më mirë që debati të zhvillohej me pyetje të drejtpërdrejta, por për hir të keqkuptimit dhe opinioneve negative që mund të zhvilloheshin, mendoj se do të mjaftoheshim me këtë pyetje:

A mund të ndodhë që hadithet e Muhammedit s.a.v.s. t'i shfuqizojnë (abrogojnë) ajetet e Kur'ani Kerimit? Të gjithë e dimë se All-llahu i Lartëmadhëruar ishte Ai që i ka shfuqizuar vetë ajetet e tij. Normalisht, do të duhej që të gjitha hadithet të janë në harmoni të plotë me ajetet Kur'anore, përndryshe ato janë të dyshimta ose jo të vërteta. Kam përshtypjen se disa hoxhallarë i kanë shfuqizuar ajetet e Kur'ani Kerimit me "hadithe të Pejgamberit" dhe janë bërë traditë e një grupi brenda ummetit tonë.

Shumëkush, të bindur në pastërtinë e Muhammedit s.a.v.s., thënie dhe veprimet e tij - hadithet i kanë marrë si të pagabuara. Ato, vërtetë janë të pastra dhe, nuk ka kurrfarë dyshimi në to sepse All-llahu i Lartëmadhëruar na ka siguruar se ai s.a.v.s., nuk fliste nga hamendja e tij, por, ishte shpallje nga i Plotfuqishmi. Por nuk duhet të mendohet se të gjitha hadithet janë të Pejgamberit s.a.v.s. edhe nëse i adresohen atij.

Myslimanët e më hershëm, e kanë pasur të vështirë t'i dallojnë hadithet e vërteta nga ato falsot, sepse jo të gjithë kanë qenë në gjendje t'i krahasojnë ato me ajetet Kur'anore. Ndërsa tani duke qenë se secili mysliman me vete ka disa lloje të mësimit (me anë të librave të shumtë dhe kompjuterëve etj.), e kanë më të lehtë t'i krahasojnë. Për dallim nga të parët tanë të cilët u formuan nëpër shkolla të shumta, ne nuk duhet të vazhdojmë sipas metodologjisë së tyre. Si ilustrim them: si ndodhi që vetëm katër shkolla (medhhebe) juridike të janë të pranuar në ummetin tonë?! Pse nuk ishin më shumë se katër ose më pak? Mua personalisht më ngjason sikur katër inxhilët e krishterëve! Ky ngjasim nuk duhet të hidhet në kosh sepse me këso "hadithe" janë përpjekur të themelojnë fillimisht shkolla të shumta prej të cilave në fund do të pranohehin vetëm katër prej tyre...

Debati mbetet i hapur

Me shumë respekt, ve selamu alejkum

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

Letër e hapur

A mund të perkufizohet Globalizmi?



Dr. Fadil MALOKU

Fenomeni i globalizmit, varësisht a e trajtojmë si proces apo si tendencë të re, mund të bëhet aq i vështirë dhe aq i komplikuar për t'u kuptuar dh për t'u shpjeguar sa që shpeshherë fitohet përshtypja, se çështja e definimit ngritët në nivel të një çështje "sizifiane". Për këtë arsye, lindin të gjithë këto mospajtime dhe kundërshti si në rrafshin shkencor, ashtu edhe në atë politik, ekonomik, e sidomos në atë kulturor e metodologjik.

Por, për ne shqiptarët, globalizmi pak a shumë ndërlihet me ngjarjen historike të spastrimit etnik dhe të kthimit pothuajse biblik, të ndodhur me përmasa gjigante (1 milion njerëz u shpërngulën nga vatrat e tyre!).

Ky shkrim pretendon të shqyrton në vija të trasha natyrën e globalizmit, që si pikënisje mëton të ketë faktin e ndryshimeve moderne të mileniumit që e lamë pas. Mirëpo, poqëse ky kontekst i shpjegimit të "mileniumit" merret si shkak për të shpjeguar një dukuri, ideologji, tendencë, apo fenomen, i cili ka ndodhë apo eventualisht do të ndodhë në të ardhmen, atëherë është e pamundur të flitet apo të prejdukohën ngjarjet, fenomenet, apo edhe ndodhitë në sferat e ndryshme të zhvillimit. E themi kështu, për arsye se natyra e zhvillimit të dukurive dhe fenomeneve të sotme është aq e shpejt dhe aq dinamike sa që vështirë mund të prognozohet, se çfarë do të mund të ndodhë p.sh. brenda një dekade, e më pak brenda një shekulli dhe shumë më pak brenda një mileniumi të tërë?!

Para një mileniumi e këndeje, p.sh. kanë ndodhur shumë ngjarje dhe shumë ndodhi të cilat e meritojnë vëmendjen tonë kureshtarë, dhe të cilat kanë lanë gjurmë në historinë e vonshme evropiane, siç janë; feudalizmi, mesjeta e hershme dhe obskurantizmi i njohur i sajë, pastaj zbulimi i Amerikës, sundimi i spanjollëve në Amerikë, luftërat fetare

(kryqëzatat), emancipimi dhe përparimi i disa civilizimeve, zhvillimi i furishëm i shkencës dhe i teknologjisë, revolucioni i borgjez francez, pavarësimi i shumë shteteve, revolucioni industriale, lufta e ftohtë e sidomos rënia e murit të Berlinit, e cila edhe shënoi simbolikisht fundin e një epike tejet tendosëse për gati pesë dekada të tëra.

Kur filloi procesi i globalizmit?

Me dioptrinë e një sociologjie empirike, do të mund poashtu të regjistrujmë se: fundshekulli XX, apo fund mileniumi i dytë në analet e historisë botërore do të mbahet mend me ngjarjet të cilat jo vetëm që e tronditën botën, por edhe e ndryshuan atë në shumë aspekte dhe në shumë rrafsh. Në të vërtetë, përfundimi i Luftës se Ftohtë, kolapsi i pësuar i ideologjisë komuniste në të gjitha dimensionet e saja etike, politike, e para së gjithash atyre ekonomike, pastaj unipolariteti i skenës politike botërore i njohur me emrin "pax americana", së bashku me kompetivitetin e formave heterogjenë të kapitalizmit të këtij shekulli dhe problemet e procesit të transicionit. Që ende janë evidente në pjesën e shteteve të dala nga sfera e ndikimit rus në Evropën Juglindore dhe atë Jugore, pastaj shtimi enorm i kompanive transnacionale në tregun botëror si edhe i ashtuquajtur "bum" aziatik (që përfshiu Japoninë,



Kinë, Malajzinë) së bashku edhe me pasigurinë e shtuar globale lidhur me energjetikën dhe ekologjinë. Janë vetëm disa nga karakteristikat që e shquan dhe e identifikuan botën e mileniumit të kaluar. Fundshekulli XX, po ashtu në analet e mediave, pastaj sferën e ekonomisë dhe sidomos në diskursin politik dhe atë shkencor do të mbahet mend edhe për promovimin e një fenomeni të quajtur "globalizëm", që deri para dy dekadash ishte pothuajse shumë pak i njohur ndër këto diskurse.

Kur bëjmë fjalë për fenomenin e globalizimit në kontekst të situatës apo këndvështrimit tonë si qytetarë të Kosovës, do të shtoja edhe të atij Ballkanik, del se ekzistonte një shpërpushje brengosëse mes këtij procesi të ri dhe mendësisë sonë zhvillimore si shoqëri dhe si kontingjent i ri në këtë rajon me përplasje të herë pas hershme: etnike, politike, ideologjike e luftënxitëse, në kuptimin e një ngecjeje të theksuar, që lë vrragë edhe në këtë Projektin e ri të integritimeve rajonale, që është duke e zhvilluar Bashkimi Evropian.

Ku gjinden shqiptarët e Kosovës në procesin e globalizmit?

Por, shqiptarëve të Kosovës për dalim prej vendeve dhe popujve tjerë në rajon që kishin dha akoma kanë si synim çështjen e ndërtimit të kapaciteteve ekonomike, politike, juridike, etj., u ra hise të bëjnë përpjekje të ndërtojnë edhe shtetin e tyre që ishte vërtetë një barrë e dyfishtë krahasuar me të tjerët në rajon. Ne pra (shqiptarët e Kosovës) në një rënë anë kishim synimin e pa realizuar të kauzës për krijimin e një tradite për ta qeverisur vetveten, e cila shpeshherë ishte e shoqëruar me defektet e metodologjisë së duhur për ta jetësuar më shpejt këtë synim, dhe në anën tjetër kishim poashtu synimin shumë joshës dhe obligativ për të ndërtuar kapacitetet nismëtare për sistemin e demokracisë që kishte filluar të fryjë menjëherë "demonstrimit civilizues" të lëvizjes studentore në vitin 1981. (Fjala "demonstrim civilizues", është përdorur vazhdimisht në vokabularin tim shkencor e politik, për shkak se kam qenë dhe vazhdoj

të jem i bindur se lëvizja studentore së bashku më Lëvizjen "Solidarnost" te pri-jësit karizmatik Leh Valensa, ishin një ndër demonstrimet e para civilizuese demokratike ne Evropën Juglindore).

Por, ndryshimet e njëmendta gjë që pajtohen edhe shumica e sociologëve të sotëm bashkëkohore ndodhen në realitet në vitin 1989 (gjë që sërish përputhet me "demonstrimin civilizues", për shkak se pati prapë demonstrata?!), kur edhe ra Muri i Berlinit, definitivisht komunizmi filloj të bankrotojë në të gjitha dimensionet e veta: ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake, kulturore, etj.

A mund te mirret viti 1989 - datëlindje e procesit të globalizimit?

Viti 1989, për shumëkënd ishte edhe datëlindje e procesit të globalizimit, anipse një numër i madh sociologësh (Gidens, Held, Fridman, etj.) e kontestojnë këtë datë duke u adresuar momenteve dhe ngjarjeve tjera historike.

Nëse i adresohemi ngadalë fillimit të shpjegimit të procesit të globalizimit nga këndvështrimi i sociologjisë bashkëkohore investiguese, do kuptuar pse sot asgjë më nuk është e njëjtë me atë që ishte dje, apo pse në përditshmërinë tonë disa gjera janë familjarizuar aq shumë sa është vështirë ta paramendojmë jetën pa to. Interneti, kompjuteri, telefoni mobil, hamburgeri, udhëtimi nëpër botë, coca-cola, filmat amerikanë, etj. Janë vetëm disa nga këto nevoja që janë familjarizuar me ne, aq sa vetëm kur mbesim pa rrymë, bie fjala, ua dimë vleftën dhe rëndësinë për jetën dhe karrierën tonë.

Në kohën e vërshimit të informacioneve, pra nga të gjitha dimensionet e mundshme mediatike, asgjë më nuk mbetet siç ka qenë, por çdo gjë rrotullohet dhe merr një trajtë tjetër identifikuese, që nuk i ngjason më shumë veçantisë sonë të mëparshme edhe kolektive e edhe individuale. Është e vetëkuptueshme që artikulli i drejtë, sistematik, i vazhdueshëm i dukurive e këndshikimeve, i interesave, etj., është një çështje e cila kërkon përkushtim dhe energji, jo vetëm analitike e shkencore, por para së gjithash edhe kohë dhe mund për t'u regjistruar këto ndryshime marramendëse për njerëzimin, që po ndodhin apo do të ndodhin në shoqëritë e këtij mileniumi të ri.

Çka është në të vërtetë globalizimi?

Se çka kuptojmë me fjalën "globalizim", nuk do të ishte mirë të përgjigjemi me një përkufizim të vetëm ekskluziv p.sh. sociologjik, jo për ndonjë shkak të veçantë, i cili mund të jetë tekefundit edhe punë "Sizifi, siç u ka ndodhur të gjitha definimeve dhe autorëve të gjer-tanishëm, por edhe për shkak se thjesht mendoj që vetëm do të shtonim edhe një syresh mes qindra e qindra përkufizimeve e definimeve që i kanë formuluar shumë studiues e ekspert të lëmive të ndryshme në botë.

Shoqëritë e vogla, siç jemi ne në Kosovë, dhe përgjithësisht rajoni i Ballkanit, kanë shans t'i japin një dimension të ri, jo edhe aq anashkalues fenomenit të globalizimit, kur të kihen parasysh ngjarjet dhe ndodhitë që e përshkuan atë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, kur në mënyrë drastike edhe u rrit interesimi për ta njohur, studiuar e shpeshherë edhe identifikuar (të shumtën e rasteve në mënyrë intuitive) këtë dukuri, fenomen dhe proces të pajisur me dimensione të reja ofruese dhe refuzuese.

Mirëpo, po që se heqim dorë tërësisht nga ky interesim dhe nga kureshtja jonë shkencore, mendoj se do t'ia humbim kuptimin interesimit tonë për ta elaboruar esencën e këtij procesi, që për shumëkënd tani ka arritur të shndërrohet në proces, fenomen, fantazmë, tendencë, e besa për disa edhe në mit!

Pra, nëse tentojmë të gjurmojmë diçka specifikuere që dosido do të mbështetet në përvojën tashmë të gjatë të sociologjisë për ta sistemuar dhe avancuar njohjen shkencore me këtë fenomen, atëherë padyshim që do të mund të sugjerojmë që me globalizëm nënkuptojmë një arenë me përmasa botërore, ku pranohen (më pak!) dhe

jepen (më shumë!) vlera të ndryshme dhe me përmasa të ndryshme varësisht nga forca, kapacitetet dhe gatishmëria e atij vendi për t'i absorbuar veçantitë e joshura nga begatia dhe mirëqenia e ofruar në mënyrë jo imponuese.

Shoqëritë e vogla, siç jemi ne në Kosovë, dhe përgjithësisht rajoni i Ballkanit, kanë shans t'i japin një dimension të ri jo edhe aq anashkalues fenomenit të globalizimit, kur të kihet parasysh ngjarjet dhe ndodhitë që e përshkuan atë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, kur në mënyrë drastike edhe u rrit interesimi për ta njohur, studiuar e shpeshherë edhe identifikuar (të shumtën e rasteve në mënyrë intuitive) këtë dukuri, fenomen dhe proces të pajisur me dimensione të reja ofruese dhe refuzuese.

Po ashtu, poqëse më tutje bëjmë përpjekje për ta definuar këtë fenomen të ri, atëherë me siguri që gjatë futjes së sondës sonë në thellësinë e problematikës që e fuqizon ky fenomen apo kjo dukuri e re, jo vetëm në diskursin sociologjik, por sidomos në atë ekonomik do hetojmë se është shumë vështirë të përkufizohet. Tekefundit, këtë "kënaqësi" rreth përkufizimit, apo si të themi definimit të tij, nuk jemi as të parët e as të fundit që po e shijojmë.

Sociologjikisht si perkufizohet?

Së pari, të provojmë perceptimin tonë sociologjik lidhur me atë se çfarë në të vërtetë kuptojmë me termin globalizim, i cili deri para dy dekadave edhe në qarqet akademike ishte i pa përkufizuar dhe shumë i pa përcaktuar. Ajo për çka ne ishim dhe vazhdojmë të jemi akoma më së shumti kureshtar, është dhe mbetet edhe më tej se a është globalizimi proces, tendencë ushtarake, trend, mit, projekt, ndonjë koncept kulturor, mënyrë e organizimit, strategji e përpunuar e ndonjë shteti a populli, apo është e gjitha këto dhe asnjëra nga to? Natyrisht, ne duhet të japim shpjegimin dhe qëndrimin tonë sociologjik, ngaqë si përgjigje lidhur me këto pyetje thuhet se sot në literaturën botërore ekzistojnë me mijëra e mijëra, ndërkaq sa u përket preokupimeve dhe kureshtjes së njerëzve anembanë botës për këtë çështje, thuhet se ekzistojnë diku rreth 200.000?! ■

(www.fadilmaloku.zor.org)

Kritikë letrare

Vetmia në figurën e metaforës

Teksti 'Ëndrra në parajsë' i Sali Bashotës nëpërmjet shenjave zbulon rrafshe të shumta kuptimore, prandaj leximi i këtyre shenjave tekstuale kërkon një lexushmëri figurative, pra tekstin duhet parë si figurë dhe si ide figurative. Artikulimi i diskursit tani në shtresimin figurshëm, ngritët dhe shënjojnë ide në strukturën e tekstit, duke e rikthyer tekstin në figurë dhe në diskursin e figurës



Flamur MALOKU

Lexim i figurshëm

Teksti 'Ëndrra në parajsë' i Sali Bashotës, botuar nga shtëpia botuese 'Rozafa' Prishtinë 2006. Edhe pse tekstin e hapë poezia, Qielli, Uji, Toka, që në esencë është edhe një lloj para-teksti për të hyrë në vetë tekstin poetik, si shenjë dhe si komunikim ideor. Mirëpo, për nga statusi i zhanrit dhe i shkrimit tekste janë proza poetike. Statusi i këtillë kategorial bëhet element strukturimi në të gjithë tekstin poetikë, si esencë teksti dhe si konceptim shkrimi. Diskursi i tillë shkrimor i përgjigjet edhe vetë tekstit në trajtën e ligjërit dhe në konceptimin e ideve, të cilat ide tani strukturohen nëpër gjithë tekstin. Idetë dhe strukturimi i tyre, tani në shkrimin e fiksionit bëhen zbulim dhe

rizbulim i asaj që është përjetuar, asaj që ka lënë gjurmë nëpër kohë. Gjurmët e dikurshme kohore tani i nënshtrohen diskursit përgjatë shkrimit dhe kodit tematik. Tematika në kuptimin e leximit dhe rileximit, thekson figurshëmërin tekstore të ngritura në simbole, ku çdo shenjë është simbolikë në paraqitjen e saj që është përjetuar, dhe që tani është rikthyer me një dhembje. Dhembja shtrihet dhe shqiptohet në përmasat e universalitetit, kjo do të thotë se dhembja nuk rri vetëm në shqiptimin personal, por në atë universal, sepse figura dhe shkrimi i figurshëm e ngritin diskursin në përmasa të këtilla. Pra, përjetimi subjektiv që tani artikullohet në shkrim, mbindërtohet në diskursin e figurshëm, si esencë kuptimi dhe si esencë figurimi. Nëpërmjet shenjave të tilla zbulohen rrafshe të shumta kuptimore, prandaj leximi i këtyre shenjave tekstuale, kërkon një lexushmëri figurative. Pra, tekste duhen parë si figurë dhe si ide figurative. Artikulimi i diskursit tani në shtresimin figurshëm, ngritët

dhe shënjojnë ide në strukturën e tekstit, duke e rikthyer tekstin në gjuhën e figurës, në diskursin e figurës. Kjo do të thotë se çdo gjë thuhet në figurë, çdo gjë shqiptohet në figurë. Kështu, shqiptimi dhe shkrimi nga konkretizimi subjektiv, si pikë e përjetuar, si pikë mbështetëse, por që tani rikthehet përgjatë i shenjave, përbrenda diskursit, merr statusin e figurshëm personal, në rendin e simboleve, gjithnjë duke prek dhe shënjuar situata. Situatat e ngritura në figurë artikulojnë plagët, si shenjë gjakimi, si rikthim i një kohe, i tillë është edhe teksti 'Gjarpri i vetmisë'. Ku prania e subjektivit gjatë përshkrimit si konceptim dhe si artikulum në përjetimin e kohës, shqiptohet nga bota e brendshme duke u identifikuar vazhdimisht, si diçka shpirtërore e përjetuar në kohë. Mbindërtimi i kohës në dëshminë e tanishme, thekson dukshëm emocionalitetin e subjektivit. Shkrimi shoqërohet me emocionalitet dhe me figurshëmëri emocionale. Shkurt, kur rikthehem në kohën e dikurshme, vetvetiu krijohet emocionaliteti. Nuk është e lehtë të rikthehem në situata të dikurshme, çdo rikthim për tek situatat e dikurshme në brendinë individuale hapë plagë. E brendshmja sa vjen dhe theksohet në kuptimin e shkrimit dhe në dëshminë subjektive. Kështu, përshkrimi i ndjenjës subjektive nuk mungon gjatë shtresimit të tekstit, sidomos kur ajo nxitet nga jashtë. Në kuptimin e kohës, ai bëhet element i strukturës së figurës tekstore, ndërsa figurat ngritën në ide e në meta-ide subjektive, të realizuara si përhershmëri autoriale, në përshkrimin e përjetimit, duke shënjuar çdoherë gjendje, siç thotë Kujtim M. Shala 'Përshkrimi i ka të gjitha shenjat e përjetimit që vijnë e konvertohen në tekst'. Gjarpri i vetmisë, kalon përmasat kuptimësisë së figurës ambientale, ai tani identifikohet me vetmin, tmerrin e vrasjes. Vrasja nuk mbetet në nuancat e një ambienti, kjo prek dhe shënjon tërë kombëtaren. Për



ta argumentuar më mirë, autori shënjon edhe vitin-1998, vit ky që është i pa harruar, si përjetim i rëndë subjektiv, 'pra është kohë lufte'. Pikëreferimi i këtillë nëpërmjet figurave ambientale, figura këto që shtresohen dhe kalojnë në vajin subjektiv dhe në vajin kombëtarë, që njëherësh jepni shkak në përshkrimin e asaj që është parë, dhe që është përjetuar në kohë. Çdo gjë rëndohet në rikthimin kujtimeve subjektive. Gjendja bëhet edhe më e rëndë në gjetjen e dorëshkrimeve të djegura, ku përjetimi autorial mbizotërohet në mallëngjim përballë dorëshkrimeve;

Kur u rriten fëmijët, i panë të gjitha gjurmët e gjakut në dhomën me dorëshkrime të djegura dhe imazhin e vendlindjes së vdekur në një kohë. Aty gjetën arkivolin e shpirtit tim. Pastaj, filluan të binin këmbanat.

Rikujtimi i së shkuarës shihet së përjetohet rëndë, ky rikujtim shënjëzohet dhe funksionalizohet shkallëshkallë, si shtresë përjetimi i mbushur me emocionalitet karshi kohës së dikurshme, pothuajse e paharruar në idenë e subjektivit ligjërues. Atmosfera e dikurshme, si njohje dhe si përvojë subjektive, vazhdimisht shoqërohet në paraqitjen e fatalitetit subjektiv, si dhembje e njohur në përmasa personale dhe kombëtare padyshim. Një gjë e këtillë del e shënuar përmes figurave, të cilat rindërtojnë ide, dhe shprehin ide.

Shenjat subjektive

Struktura e shkrimit diskursiv, me një gjuhë të figurshme dhe me plotë shtresime ideore në tekst, shënojnë para së gjithash një pasqyrim të vetmisë subjektive, e cila vetmi buron nga shumë gjëra, të cilat gjëra tani përjetohej e përkujtohej rëndë. Vetmia subjektive kalon në figurën e metaforës shpirtërore. Si sintagmë mund të themi se del e shënuar pothuajse në të shumtën e teksteve poetike. Kjo tani kalon në figurë të artikulimit shpirtëror, si shprehje e brendësisë subjektive, e cila tani eksplicohet në strukturën ideore;

Sa shumë lule të thara në tryezën e rrumbullakët. Si zakonisht, një sfond i rëndomtë i mëngjesit e fytyrës me sapun, krehja e flokëve, vrasja e ëndrrave në ndërgjegje, gjimnastika e mëngjesit, prapë pastrimi i dhëmbëve, vizatimi i një kukuvajke në muret dhomës...

Metafora e vetmisë, e shprehur në kohën e ligë, siç mund të themi, e bënë subjektivin të shpalos brendinë, e cila brendi rikthehet në një ditë të dikurshme, tani vetëm si kujtesë. Pra, rilidhet shumë gjendja më të dikurshmen jetësore, e cila ishte

vetëm mërzi dhe shqetësim në kuptimin e ditës jetësore, sepse çdo gjë ishte kaos, dhembje. Prandaj, kjo kishte kaluar në diskursin e monotonisë, e cila tani në shtresimin shkrimor dhe në rikujtimin e saj e rritë dramaticitetin autorial. Kështu, ligjërimi i shtresimit dhe i paraqitjes së kësaj vetmie subjektive, e thurur si gjakim shpirtëror, jepet nëpërmjet vetërrfimit, me plotë emocionalitet, si shtresim dhe si mundësi e shprehjes së një jete më plotë dhembje dhe shqetësim shpirtëror. Mirëpo, rendi i strukturimit dhe i argumentimit, në kuptimin e mbindërtimit të jetës së dikurshme, bëhet edhe me e ndjeshëm, sidomos kur preken çaste intime subjektive, përballë një dashurie, e cila në esencë ka krijuar një imazh të keq. Vetë dashuria e kohës së dikurshme e pozicionon subjektivin në përshkrimin e saj, të cilën dashuri autori e rikthen në figurë;

Ajo kishte duar të ftohta, por edhe shpirt të ftohtë E ftohtë ishte edhe puthja. Pikërisht, aty shkrihej peisazhi i vjeshtës dhe bryma e bardhë. Mirëpo, natyra e rrethuar me ofshamë të keqe dhe e spërkatur më lotët e fëmijës së zvogëluar në hapësirën e oborrit, kishte marrë trajtë, formë apo ngjyrë tjetër.



Shihet së tërë ajo dashuri shënohet përmes gjuhës së figurshme, duke krijuar kështu, një konotacion të vetë tekstit dhe nëntekstit të saj. Imazhi i keq, i cili ka mbetur si kujtesë, tani ai konvertohet dhe i nënshtrohet padyshim edhe zhgënjimit subjektiv. Disa nuanca përshkrimi që subjekti i bënë kësaj dashurie, zgjedhën nga subjekti si një argumentim i këtij imazhi të keq, siç janë; duar të ftohta, shpirti i ftohtë, puthje e ftohtë, bryma e bardhë, vjeshta, klithma, fantazma e tjera. Të gjitha këto figura japin pamjen e asaj dashurie të porealizuar, e cila ka mbetur e ftohtë në shpirtin e subjektivit. Në gjuhën e figurshme ndërtohet e rindërtohet edhe teksti tjetër poetik, 'Buzëqeshja', edhe këtu përshkruhet ndjenja ndaj bukurisë femërore, çdoherë si përherëshmëri kujtimi, ajo ngritët nëpër pika e përshkrimi, të cilat thurin diskursin mbi bukurinë e femrës. Kështu, përkufizohet tërë ajo që subjekti ndjejnë për të, si bukuri dhe si dashuri, mbi të gjitha në humanitetin që posedon ajo. Janë këto tema që shtjellohen gjithnjë si kujtim dashurie, e që tani rikthehen në emocion e në figurë të shqiptimit të artikulluar në përshkrim.

Kështu, marrë në përgjithësi, teksti 'Ëndrra në parajsë' sintetizon shkrimin e meditimit, që prekët dhe bëhet normë e ligjërimit. Prandaj, Sali Bashota sjellë një gjuhë të figurshme poetike të matur dhe të artikulluar më mjeshtri prej një poeti bashkëkohor, si në rrafshin e meditimit, ashtu edhe në atë të konceptimit. ■

Letërsi

Poezi

Një pikë vesë mbi barë



Qerimane POLISI

KOSOVËS

Tokë lotësh që dallgët të dalldisen
Sa herë që era fryn mbi ty me furi
Tokë që me gjak ujit çdo damar
Nga djemët që trupin ta falën për liri.

Ti që emrin ta di edhe më i vogëli fëmijë
Ta trazuan zemrën por nuk tu dridh qerpiku
Se lotët dalin teren, ti mbetesh kala
Të dua, të dua vend si ti nuk ka.

Nënat, nënëloket rritën djem viganë
Që lules së ballit armikut plumb i dhanë
Nenëzat i rritën për tokën e shtrenjtë
Me kujdes i edukuan i bekuan vetë

Nëna, mëmëdhau një zemër një shpirt
I rritën fëmijët i mbajtën në gji
nëna rriti trima për liri si ari
mëmëdheu i pritni nderin ua fali.

e fituan nderin e pavdekësisëse
se na sollën dritë në errësi
zemrën dhe syrin nga ty i kemi
krenar para botës me ty do të jemi.

PRES

Po pres një diell që po vonon
Po pres një hije që perëndon
Po pres unë, pret një komb
Shqiponja tund flatrat lart mbi një shkëmb.
Po presin varret dhe amaneti
Që të lundrojnë si barka mbi valë deti
Po presim që dielli atje lartë në re
Të na kumtojë lajmin më të pritur për ne.

U NISËN

Një lot, një pikë vese mbi barë
një lule, një mall që djeg si zjarr
e lamë prapa me kohën që vjn
Mbanë në vete kujtime e mall.

Lule e rinisë ngadalë po vyshkën
e fëmijët si plepi i lartë
malli i nënës shtohet e rritet
për nipat e mbesat që s'i ka afër

Po ku mi trete këto pëllumba
në këtë mëngjes të bukur pranveror të bardhë
me lotin e nënës u nisën e shkuan
malli për to shtohet si guri në arë
malli për to djeg si zjarr.

KU JE

Po ku je ti që u rrite
Në këtë sofër me therrime
More rrugën diku shkove
E me le veteëm në mendime

Disa herë të merr malli
Për tokën e ujin e ftohtë
Por në vend të tyre atje
Do të kësh ti vaji e lot.

U bëre çka deshte vetë
Por më s'u ktheve në shtëpi
Të vatra e nënës te buka e ngrohtë
Te shtëpia e zbrazur që e le me lot

Ministria e Kulturës, e parëndësishme



Berat DAKAJ

Ngjarjet e jashtëzakonshme ndodhën gjatë fushatës zgjedhore, por më të pazakonshmet në ndarjen e ministrive ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së, parti pozitive) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së, opozitare). Për ç'arsye? Ja pse! (Po shkruaj, por pa futur asgjë në thonjëza. Mos prekeni askush!).

Partia Demokratike e Kosovës (më shumë e Hashim Thaçit) pasi fitoi shumicën e votave, për gati dy muaj mbeti peng për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Kryeministrit të sotëm nuk i ngutej formimi i Qeverisë së tashme, por as ndarja e ministrive. Vetë u bë kryeministër, ju të tjerët pritni të bëheni ministra! Por, pse jo edhe mos të rrinë në akth të pritjes!

Që në hapat e parë të formimit të Qeverisë, Thaçi përpiqej të merrte sa më shumë e të jepte sa më pak. Këtë qëllim kishte.

Nisi ecjen me të prekura. Bëri koalicion me partitë e tjera jashtë qendrës (nëpër komuna sidomos me AKR-në e Behgjet Pacollit), por tentoi edhe në qendër. Zëri i huaj provokues i erdhi anash që mos ta kalojë LDK-në. Dhe u bë ç'u bë?! PDK-ja brenda strukturës së saj futi edhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (lidhje e shkapërderdhur), me program krejt tjetër nga ai i PDK-së, por ja që u morën vesh të udhëheqin së bashku.

Sapo bën marrëveshje, PDK-ja (përgjithësuese) u ngut. Gaboi! Pse? U nis t'i marrë ministritë e vlefshme, ato që kanë para. Kurse Ministrinë e Kulturës ia dha LDK-së, duke e marginalizuar atë dhe duke e parë si të pavlerë. Pra, diçka si fundërrinë, si kitch, schund. S'ka para në të.

Thjesht, disa liderë qeveritarë të PDK-së, e injoruan kulturën. Ata iu jepnin deklaratat mediave se, LDK-së ia kemi lënë disa ministri të parëndësishme. Njëra prej tyre doli se ishte edhe Ministria e Kulturës. Çfarë paradoksi bashkëkohor!

Të njëjtat pohime për Ministrinë e Parëndësishme i bënin edhe disa nga analistët tanë politikë. Natyrisht që këta (analistët) gjykonin dhe vlerësonin veprimet që kishte marrë PDK-ja. Pra, vlerësonin ngecjen (vonesën) e mosmarrëveshjes!

Ministria e Parëndësishme, e tillë që edhe gjatë udhëheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës. Atëkohë ministër i saj që Haraqiu!

Thaçi i Qeverisë së Kosovës, shef i PDK-së, gjatë fushatës zgjedhore, madje bërjes kryeministër, thoshte dhe tha se një nga qëllimet kryesore të tij do të jetë edhe çështja e kulturës, rinisë, sportit. Çështje këto me prioritet. Ndërkohë që, kur u zgjodh kryeministër, nuk veptoi ashtu. Historiani e harroi historinë e Ministrisë së Kulturës, të bërat bum të saj.

Prandaj, nëse për një kohë të gjatë në mediat tonat, gjatë qeverisë së kaluar, është parakaluar Ministria e Kulturës për të keq, PDK-ja në asnjë mënyrë s'është dashur që sot atë t'ia lë në udhëheqje LDK-së. Për ç'arsye mund të thuhet kështu? Këtë ministri atëkohë e pati udhëhequr LDK-ja, pra zotrote

Haraqiu! Sot, prapë LDK-ja, por me Skendon në krye. Njërit i pëlqenin motorët, tjetrit i pëlqejnë kinemaja dhe teatri, por, pasi që del në orën 19.00, 20.00, e edhe në mesnatë nga zyra e Ministrisë së Parëndësishme, nuk ka kohë të jetë vizitor i asnjëres.

PDK-ja, që atëkohë që në opozitë, qeshte me veprimet e kësaj ministrie dhe ministrit të saj, pra zotrote Astrit Haraqiu!

Nuk mendoj se Skenda do të jetë si Haraqiu! Assesi s'paragjykoj këtë! Mos e dhashtë Zoti të gabojë Skenda si ai! I zë besë shumë Skendos, është më i vjetër dhe, natyrisht, më i pjekur.

Kështu që, duke lexuar në medie e dëgjuar e parë nëpër TV e radio fjalët dhe lëvizjet e duarve të Hashimit, vura bast, me një shokun tim, me nga një kafe, që PDK-ja do ta ketë këtë ministri. Megjithëqë, kur u ndanë ministritë, lexova në një nga gazetatat tona se Ministria e Kulturës iu dha LDK-së. Thënë të vërtetën, atë ditë, ishte e martë, hiq nuk mund të paragjykoja se mund të jetë e vërtetë.

Por, kënga sot për të këndohet ndryshe. Me të kulturuar edhe në këtë Objekt Kulture tani prapë janë të LDK-së. Sjellja e ish-ministrit Haraqiu në këtë ministri dhe mirësjellja e tij me buxhetin e ndarë kësaj ministrie atëkohë, aspak, fare hiq nuk u kaloi në mendje liderëve të PDK-së që këtë ministri ta marrim në dorë vetë. Sido që të jetë, mirë që sot nuk është njeriu i PDK-së në krye të kësaj ministrie. Pale se çfarë skandalesh dhe haraçesh do të kishte bërë e vënë ai në këtë ministri të konsideruar të pavlerë.

Edhe nëse sot Skenda s'mund të bëjë diçka më shumë se ministri Haraqiu për kulturën në atëkohë, zë besë se edhe më i ligu, qoftë në pamje fizike, qoftë edhe nga mendja, mund të kishte ardhur nga PDK-ja.

Pse thuhet kështu? Ngaqë nga PDK-ja erdhi qëndrimi përgjithësues se Ministria e Kulturës... është Ministri e Parëndësishme dhe, duke qenë e tillë, ajo duhet t'i takojë LDK-së!

Dashtë Zoti që sivjet kjo Ministri e Parëndësishme t'i ndajë paratë për një film të rëndësishëm. Ministri Skendo ka premtuar, shefi i ministrive (Thaçi) duhet t'i shpërndajë të hollat dhe t'i mbajë fjalët dhënë gjatë fushatës.

Le të bëjë ai më shumë për kulturën, edhe ne jemi të gatshëm që edhe me këtë ministër t'ia falim gabimin e lëshuar. Ndhimjoje Skendon Hashim që të na ndihmojë edhe ai neve! Qofshi me shëndet e faqebardhë!

■ Opinion

Muzeu Etnologjik i Prishtinës letërnjoftim i trashëgimisë kulturore

Ky muze ka arritur që brenda vitit 2007, të bëhet një ndër muzetë më të preferuara në rajon për shkak të objekteve karakteristike qytetare të shekullit 18 dhe 19, si dhe ekspozitës e cila e prezanton jetën në Kosovë prej shekullit 16 deri 20

Genta HOXHA

Gati nuk ka të huaj, të cilët e kanë vizituar Prishtinën dhe të cilët nuk i ka nxitur kureshtja se çfarë fshihet në ndërtesën e shekullit XVIII të Muzeut Etnologjik. I panjohur shumë deri në fillim të vitit që lamë pas, ky muze bëri një kthesë befasisuese në saje të mbështetjes ndërkom-bëtare dhe punës së ekipit që drejton atë. Ajo që më së shumti ka ndihmuar afirmimin e muzeut padyshim është anglezja Elizabeth Gowing. Të njëjtën gjë ajo ka premtuar se do ta bëjë edhe më 2008.

Viti i begatshëm për muzeun

“Për njëmend ka qenë një vit i zënë për muzeun. Në fillim të vitit, njerëzit nuk kanë ditur që ekziston”, është shprehur anglezja Elizabeth Gowing, një prej koordinatorëve të projekteve të muzeut. Puna e saj ka bërë që muzeu brenda një kohe të shkurtër të shndërrohet në pikë reference në aspektin kulturor për shumicën e të huajve që punojnë apo e vizitojnë Kosovën, por edhe për shumë vendës që më parë nuk kishin pasur njohuri për të. “Tash besojmë që qytetarët e dinë që muzeu ekziston, e dinë sa kanë për çfarë të jenë krenarë me traditat”, ka vazhduar ajo. Gowing shprehet e entuziazmuar që tani ky muze është në mendjet e njerëzve dhe së shpejti edhe në hartat e kryeqytetit dhe shtetit të ardhshëm. Ajo ka rrëfyer përvojat e saj nga vizitat e fëmijëve nga shkolla të ndryshme të kryeqytetit, të cilët, sipas saj, kanë dëgjuar me kujdes historinë e muzeut, kanë vizituar së bashku me artistët e projektit “Artistë në rezidencë”, dhe kanë bërë fotografi të shkëlqyeshme duke ndjekur këshillat e fotografes profesionale. “Familje të shumta në

Kosovë dinë për muzeun dhe e kanë vizituar atë gjatë verës. Vizitorë nga diaspora kanë ardhur me ngrënë fli ose pite, të përgatitura në oborrin e muzeut në mënyre tradicionale dhe të shijshme”. Shumë prej tyre, janë kënaqur edhe duke dëgjuar muzikantët duke i rënë çiftelisë ose sharkisë, ose për shembull për t’u takuar me pleqnarin që ka treguar rrëfime nga tradita e odës së burrave në Kosovën e mes shekullit të 20-të. Mirëpo, edhe të huajt nuk kanë mbetur anash, bile, sipas Gowing, ata kanë qenë pjesë e vazhdueshme e aktiviteteve të organizuara në muze. Gowing rrëfen se si shumë ndërkom-bëtarë kanë vizituar muzeun çdo të shtunë. “Ata kanë ardhur edhe veç për qejf, për t’i takuar ciceronët e aftë, për të kuptuar më shumë për historinë dhe traditat e Kosovës, për të kaluar një ditë në një vend të bukur dhe të vjetër në mes të Prishtinës së betonuar”, shprehet anglezja. Një nga qëllimet e muzeut, sipas Gowing, është që çdo vizitor në Kosovë dhe nga jashtë të dijë për muzeun. “Besojmë që taksistët janë ambasadorë shumë me rëndësi për vendet me interes në Prishtinë. Ata

kanë kontakt me vizitorë dhe mund t’i tregojnë çka mund të vizitojnë në qytet”, mendon Gowing.

Flija dhe muzika me çifteli

Koordinatorja Alisa Gojani shprehet se për ta sjellë muzeun në këtë nivel afirmimi, është dashur shumë punë. Sipas saj, brenda 2007-s janë realizuar një varg aktiviteteve si: pjekja dhe servimi i flisë, pites, pastaj rrëfimet e pleqnarit, muzika “live” me çifteli, thurja me vek etj. E tërë kjo, sipas Gojanit, është bërë në mënyrë që vizitorët të lidhen sa më shumë me ekspozitat që gjenden në muze. “Ky muze ka arritur që brenda vitit 2007, të bëhet një ndër muzetë më të preferuara në rajon për shkak të objekteve karakteristike qytetare të shekullit 18 dhe 19, si dhe ekspozitës e cila e prezanton jetën në Kosovë prej shekullit 16 deri 20”, ka vlerësuar Gojani. Projektet e tjera si vazhdimësi e këtyre projekteve, kanë qenë edhe artisti në rezidencë, që është sponsorizuar nga shefi i Zyrës Ndërlidhëse Holandeze në Prishtinë, si dhe fotografi në rezidencë, që është sponsorizuar nga Zyra britanike. Ky i





fundit e ka pasuruar muzeun me dy mijë kartolina dhe tre aparate digjitale, që do të jenë në shërbim të vizitorëve. Si vazhdimësi e këtyre, është dhe projekti me punë dore në rezidencë, si dhe shumë projekte të tjera që, sipas Gojanit, janë në plan të realizohen gjatë këtij viti.

Gojani ka bërë të ditur se brenda një viti, Muzeu Etnologjik ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të cilat e kanë shndërruar atë në vend të preferuar për shumë ndërkombëtarë dhe vendorë. Disa prej vizitorëve të rregullt ndërkombëtarë tanimë janë bërë miq të muzeut, si: Elizabet Gowing, e cila

ka dhuruar ndihmën e saj vullnetare për simpatinë që ka ndaj muzeut, Suzan Farbman, Carel Blunt, Cindy Wickof, David Blunt, Robert Wilton, Huges Conructive etj.

Zyrat ndërlidhëse – mbështetësit më të mëdhenj

Muzeun, sipas bashkëkoordinatores Gowing, e kanë ndihmuar shumë të huajt, sidomos zyrtarët nga zyrat ndërlidhëse ndërkombëtare, që gjenden në kryeqytet. Carel Brands nga Zyra holandeze, sipas Gowing, i ka dhuruar fonde muzeut për

javën e artistëve në rezidencë, projekt ky që ka joshur shumë vizitorë dhe ka paraqitur interes për muzeun. Edhe Zyra britanike me shefin e saj David Blunt, ka dhuruar mjete financiare për javën e fotografisë në rezidencë, që ka kaluar me shumë sukses. ■

Historiku i Eminxhikut

Kompleksi i përberë prej tri ndërtesash të Eminxhikut (Shtëpia e mysafirëve, Eminxhiku, shek. XVIII, shtëpia e familjes, haremllekë shek. XIX dhe stalla e kuajve shek. XIX) ka qenë pronë e familjes së kamur të Prishtinës, Hajrullah Eminxhikut. Pronarë të tjerë, sipas dokumentacionit të Institutit të Monumenteve dhe Muzeut Rajonal të Prishtinës, përmenden Azize Eminxhiku dhe Hilmije Eminxhiku. Familja Eminxhiku ka qenë pronare e këtij kompleksi deri në vitet 60- ta të shekullit XX, në të cilën kohë ata siç duket janë shpërngulur në Turqi. Më pas kompleksi i ndërtesave të Eminxhikut është nacionalizuar, është shpallur në vitin 1955 monument i trashëgimisë kulturore historike dhe i është dhënë në shfrytëzim Muzeut të Kosovës. Gjithnjë sipas dokumentacionit të Institutit të Monumenteve dhe Muzeut Rajonal të Prishtinës, kompleksi i ndërtesave të Eminxhikut fillimisht ka qenë pronë dhe është ngritur nga familja Gjinolli, e cila në burimet historike të shekullit XVIII dhe XIX radhitet ndër familjet me të pasura dhe më të ngritura të Kosovës. Nga kjo familje shquhet Jashar Pashë Gjinolli i cili në shekullin XIX kishte ngritur në Prishtinë muzeun e familjes Gjinolli, që njëherazi radhitet ndër muzetë me të vjetër në Evropën Juglindore.



Kreativiteti dhe inteligjenca emocionale



Dr. Ali ILJAZI

Hulumtimet kanë treguar që vetëm koeficienti i inteligjencës (IQ) nuk është garanci për sukses në jetë. Andaj, sot për të siguruar zhvillim të “personit komplet” nevojiten (IQ) e lartë dhe koeficient i lartë emocional (EQ). këto dyja janë në lidhje të ngushtë.

Dobia e zhvillimit paralel të inteligjencës suaj emocionale përderisa zhvilloni edhe inteligjencës tuaj kognitive nënkupton jetën e suksesshme në punë, ngritjen e shëndetit fizik dhe mental, si dhe arritje e kualitet më të madh në marrëdhëniet me tjerët.

Psikologët kanë zbuluar dhe ndarë inteligjencën në tre grupe kryesore:

-inteligjenca abstrakte (aftësia e të kuptuarit dhe udhëheqja me shfrytëzimin e simboleve verbale dhe matematikore).

-inteligjenca konkrete (aftësia e kuptimit dhe udhëheqja me objektet)

-inteligjenca sociale (aftësia e kuptimit të njerëzve dhe lidhshmëria me ata).

Inteligjenca emocionale (EI) i ka rrënjët në konceptin e “inteligjencës sociale” të cilën për herë të parë e ka identifikuar E.L. Torndike në vitin 1920. Ndikimi i këtij koncepti në kulturën e gjerë dhe në shoqërinë akademike prej atëherë ka qenë i shpejtë dhe i gjerë.

Siç e dimë, emocionet janë pjesë themelore e asaj që vërtetë jemi, dhe që luajnë rol të rëndësishëm në marrëdhëniet me tjerët. Ato nuk mund të tejkalohen. Por, shumica prej nesh është orientuar tradicionalisht në ‘emocionet ti lërë te shtëpia’ në bindje që duhet, që të jemi më efektiv, të gjitha planet tona dhe vendosjet ti bazojmë vetëm në inteligjencën e “ftohtë” dhe logjike.

Në realitet, ky qëndrim garanton që emocionet e shtypura te ndizen, shkaktojnë ngritjen e përlëshjeve dhe ndikojnë negativisht në disponimin e individit. Por, çfarë nëse njohurit tona për emocionet vazhdojmë ti përhapim bashkar-

isht, si një “lloj të dytë të inteligjencës”, jashtë mendjes dhe logjikës?

Mund të thuhet se distancë më e madhe, është distanca në mes mendjes (IQ) dhe zemrës (EQ).

Le të vërejmë disa çështje dhe tema të rëndësishme në lidhje me inteligjencën emocionale.

Ç’është inteligjenca emocionale EI?

Kur Satovey dhe Mayer në citin 1930 e kanë definuar termin “inteligjencë emocionale”, kanë qenë të vetëdijshëm për hulumtimet e mëparshme të aspektit kognitiv të inteligjencës. Inteligjencën emocionale e kanë definuar si ‘formë të inteligjencës sociale, e cila përfshin aftësinë e njohjes së emocioneve vetanake

Përse na nevojitet EI?

Reaksionet emocionale paraekzistuese të EI sonë janë çelës kah shëndeti më i mirë, në përjetimin më të madh të lumturisë dhe afërsisë, në arritjen e udhëheqjes më të fuqishme, vizionit më të qartë, suksesit më të madh, qëllimeve më të larta, përhapjes e fuqisë dhe energjisë sonë, përparimin më të madh të gjërave, sigurimi i marrëdhënieve të shëndosha dhe perceptimit të hollësishëm si dhe në fund në arritjen e kënaqësisë më të madhe.

Këto reflekse emocionale, rrallë të vetëdijshëm, janë portë e fuqishme që motivojnë vendosmërinë tonë. EI nevojitet që të realizojmë fuqinë e emocioneve tona.

Në modulin e Golemanovit të EI ekz-



dhe te tjerëve, dallimin e të njëjtave dhe shfrytëzimi i informacioneve të dhëna gjatë mendimit dhe veprimit.

Esther Orioli dhe Robert Cooper kanë theksuar në përpjekjen që të shpjegojnë EI: EI është shumë më tepër se sjellja e “bukur” ndaj tjerëve. Kjo është aftësi që të ndiejmë, kuptojmë dhe me sukses të praktikojmë fuqinë dhe mundësinë e emocioneve si burim i energjisë, informative, kreativitetit, besueshmërisë dhe afërsisë.

Mundësia e dytë e definimit të EI është aftësia që të ndiejmë dhe shfrytëzojmë emocionet për “vetëudhëheqje” të suksesshme dhe veprim në kahet pozitive në ndër marrëdhëniet tona.

istojnë pesë hapa kyç (aftësi): vetëdija, vetëkontrolla, vetëmotivimi, empatia dhe ndërmarrëdhëniet e suksesshme, secila nënkupton përmbledhje e aftësive të ndryshme. Nuk është e domosdoshme që të gjitha aftësitë të jenë të suksesshme, por dy janë aftësi kyçe (vetëdija emocionale dhe vetëvlerësimi preciz) të domosdoshme. Këto janë dy aftësi themelore në të cilat fillojnë të gjitha të tjerat.

Vetëdija

Guri themelor ose themeli i EI është vetëdija. Kjo lëvizje aftësitë e tjera të EI. Vetëdija duhet të jetë në radhë të parë, sepse nëse nuk e njohim vetën dhe nëse nuk dimë çfarë ndiejmë, si do të dimë

cilat janë nevojat e tjerëve ose ti kuptojmë tjerët dhe të paramendojmë atë që ata ndiejnë?

Sa më tepër dimë për vetën, aq më tepër kemi mundësi të kontrollojmë dhe zgjedhim mënyrën si do të sillemi në situatën konkrete...

Gjatë ditës pyeteni vetën si ndiheni dhe mu këtë rast bëhuni të sinqertë ndaj vetit. Nëse zemra u rrahë shpejtë, jeni të skuqur në fytyrë dhe ju mungon ajri – këto rëndom janë shenjë për diç. Pyeteni vetën: ‘çfarë ndjenje fshihet prapa kësaj?’ Emërtoni këtë ndjenjë – frikë, anksozitet, dashuri, pasiguri.

Bëhuni të hapur nda këshillave të tjerëve. Miqve dhe bashkëpunëtorët shpesh mund të na ndihmojnë të kuptojmë sjelljen personale.

Vetëkontrolli

Përderisa si hap kah vetëdija dëgjojmë ndjenjat tona dhe mësojmë nga ato, vetëkontrolli është kontrolli dhe udhëheqja me këto ndjenja, kështu që nga këto të ketë më shumë të mira se sa dëm. Vetëkontrolli krijon anën racionale dhe kohën që të qetësojmë ndjenjat kur është nevoja. Gjithashtu na ndihmon të veprojmë me qëllim, e jo në mënyrë impulsive.

Nëse veprojmë me qëllim më parë do të mendojmë atë që themi: Ana tjetër e medaljes do t’ishte, e reaguam pa mendim e pastaj me ndie keqardhje për këtë. Ja disa këshilla që do t’ju ndihmojnë të vetërregullimi:

Kontrolloni atë që i flisni vetit. Bëhuni të vetëdijshëm për këtë (kur i drejtohem vetit në mendime)

Ndërmerrni përgjegjësinë për reaksionet tuaja emocionale në jetë. Kur ndieni se jeni të pa parashikuar, pranoni fuqinë personale.

Parashihni ndërprerësit “emocional” dhe përgatituni në udhëheqjen me reaksionit në këto.

Secilën situatë irituese formësoni në “ushtrim të zgjedhjes së problemit”. Kur ballafaqoheni me situatën, e cila shkakton reaksion të padëshiruar emocional zvogëloni zemërimin tuaj ashtu që do të forcoheni në sjellje.

Këtë formësoni kështu që sjellja të bëhet problem e jo personi në fjalë

Shërbehuni me humor!

Asnjëherë mos nënvlerësoni fuqinë e

frymëmarrjes së thellë. Rritja e rrjedhës së ajrit kah truri zvogëlon tendosjen, qartëson mendimet, dhe vepron në mënyrë relaksuese në psikë dhe në trup.

Vetëmotivimi

Vetëmotivimi është orientim i fuqisë së emocioneve tona kah qëllimi, i cili do të na motivoj dhe inspiroj. Ky edhe është paramendim si e realizojmë një qëllim dhe ndërmarrje e gjithë hapave të nevojshëm për të arritur tek ai.

Disa mënyra të cilat do ta përmirësojnë motivimin tuaj:

Bëhuni të vetëdijshëm për mënyrën me

Disa teknika të EI-së me të cilat do të kemi marrëdhënie më të mira në punë

- Ndani epshin dhe entuziazmin tuaj ndaj punës suaj dhe vizionit të organizatës suaj – kjo është infektuese! Të keni vizionin në atë formë që hovin tuaj do ta përcillni ndaj një projekti ose qëllimi;
- Krijoni atmosferën inspirative të punës;
- Bëhuni të përgatitur që të udhëhiqni dhe ti ndihmoni të tjerët, por gjithashtu që të tjerët t’u ndihmojnë dhe të udhëheqin me ju...

të cilën i shpjegoni vetit lëshimet tuaja në jetë... qëndroni real. Kuptoni që mund të kontrolloni dhe zgjidhni çfarë do të mendoni dhe ndieni. Rriteni këmbënguljen tuaj ashtu që gjithnjë do të jeni të vetëdijshëm për qëllimin në jetë. Të keni parasysh qëllimin dhe bëhuni këmbëngulës, kështu që mund të jeni të kënaqur në arritjen e fundit të suksesshëm të çdo gjëje që keni filluar. Anoni kah ajo që të arrini gjendje “fluturuese” derisa punoni në projekte.

Meditoni!

Empatia

Empatia nënkupton mundësinë e shikimit të problemit nga perspektiva e

personit tjetër. Ajo fillon me dëgjim, që do të thotë vendosje e marrëdhënieve me njerëzit. Empatia është ngjitet i cili do të lidhë një grup që të bashkëpunoj me sukses.

Hulumtimet tregojnë që fjalët përbëjnë vetëm 7 % të komunikimit. Toni dhe shpejtësia e të folurit përmbajnë 38 % të mesazhit, ndërsa 55 % mbetet e pa folur dhe zbulohet nëpërmjet të folurit të trupit, siç janë qëndrimi, kontakti me sy, shprehjet e fytyrës etj.

Ndani ndjenjat tuaja me tjerët dhe bëhuni të sinqertë. Komunikimi i mirë udhëheqë kah besimi. Mesazhet tuaja të folura dhe të pafolura duhet me qenë të njëjta. Mendoni atë që flisni për të mbajtur atë që bëni. Kjo tregon se jeni të sinqertë apo autentik, për çfarë ndërtoni besim.

Mundohuni të vëreni situatën nga perspektiva e personit tjetër. Empatia është të paramendoni si do t’ishte me qenë në lëkurën e tjetrit.

Ndërmarrëdhëniet e suksesshme

Mbizotërimi i aftësive të vetëdijes, vetëkontrollit, vetëmotivimit dhe empatisë udhëheqë kah mjeshtëria e mbajtjes së ndërmarrëdhënies të suksesshme me njerëzit dhe me qenë në mundësi që të mbahemi dhe të udhëheqim me emocionet e tjerëve. Me mjeshtri të larta sociale udhëheqësit janë komunikues dhe kolaborist më të mirë.

Përfundim

Aftësitë e EI, ato të kthyerat kah ne dhe ato ndërnyerëzore, kanë rëndësi e normë për jetën dhe paraqesin një inteligjencë tjetër. Këto janë mjet që të formësojnë kuptimin e termeve kryesore siç janë dashuria, suksesi dhe lumturia. Është argumentuar që (EI) është më e rëndësishme se (IQ) (aftësitë teknike) gjatë përcaktimit të suksesit në jetë. Për ndryshime të (IQ) i cili është i pandryshueshëm, njerëzve që ta përmirësojnë vetëdijen për veten dhe tjerët, të krijojnë bashkëpunim dhe harmoni.

Në praktikë, gjithashtu u ndihmon njerëzve të bëhen të vetëdijshëm për mundësitë e tyre, burimet e tyre të fuqisë dhe kreativitetit dhe që me vetëdije të zgjedhin reaksionin më efektiv në situatën e dhënë, e jo që të reagojnë vetëm në mënyrë impulsive. ■

Meningjiti - infeksion serioz

Derisa vendet përreth nesh tani më janë duke u përballur për mbrojtje nga epidemia e meningjtit, mantelëbardhët e Kosovës ende nuk e shohin të rrezikuar vendin nga kjo sëmundje.



Artan BEJTA &
Iliriana ALLOQI

Meningjiti është inflamacion i cipave që e mbulojnë trurin dhe palcën kurrizore. Shkaktarë më të shpeshtë janë viruset ose bakteret. Sipas fatalitetit (vdekshmërisë), meningjiti viral zakonisht është më i lehtë, ndërsa ai i shkaktuar nga bakteret (bakterial) paraqet infeksion serioz që shpesh mund të përfundojë me vdekjen e të sëmurit nëse nuk ndërhyhet shpejt me terapi për ta mjekuar këtë sëmundje.

Simptomat e përgjithshme

Sëmundja e meningjtit shoqërohet me simptomat e para të

saj, e po ashtu edhe me simptoma në stadet e avancuara të saj. Shenjat e para të sëmundjes janë: duart dhe këmbët e ftohta, dhembje në këmbë dhe ndryshime anormale të ngjyrës së lëkurës. Kurse ndër simptomat e tjera të shfaqura në stadet më të avancuara të sëmundjes janë: temperaturë, ethe, dhimbje koke, të vjella, neveri ndaj ushqimit, mpirje të qafës, probleme me ndriçimin dhe dritën e diellit, përgjumje, elemente në lëkurë në formën e ekzantemave (ndryshime të kufizuara në ngjyrën e lëkurës) apo hemorragjive etj.

Grupmoshat më të prekura

S'ka dyshim se më të rrezikuarit nga kjo sëmundje janë fëmijët, nën moshën pesë vjeçare, e nga këta edhe më të rrezikuar janë ata që ende nuk i kanë mbushur një vjet, mirëpo kjo nuk do të thotë që meningjiti nuk i prekë moshat e shtyra.

Kjo sëmundje mund të zhvillohet shpejtë dhe në format më serioze të shfaqjes, meningjiti mund të jetë shpesh vdekjeprurës.

Kur dyshoni se fëmija juaj ka meningjit?

Te foshnjat zakonisht vërehen këto ndryshime:

Pjesë e butë e dalë ose e fryrë në kokën e fëmijës, kundërshtimi i ushqimit pa marrë parasysht i çfarë llojit është ai, është nervoz kur merret për ta shëtitur ose thjesht për ta mbajtur në duar dhe zakonisht qanë me zë të lartë dhe rënkues, trupi është me lëvizje të pakontrolluara me një fjalë i këputur ose sikur i pajetë.


Meningjiti viral

Meningjiti viral (i shkaktuar nga viruset) është forma më e lehtë e meningjiteve dhe atakon kryesisht fëmijët deri në moshën 15 vjeçare. Shkaktarë janë viruset e ndryshëm (arenavirusët, arbovirusët, etj.). sëmundja ka ecuri akute (të shpejt) mirëpo nuk len pasoja e për këtë arsye shpesh quhet edhe meningjiti beninjë (i mirë).

I sëmurit ka një temperaturë të tllartë e shoqëruar me ethe dhe të dridhura, dhembje koke të cilat rëndohen nga ngacmimet e jashtme (drita, zhurma, etj.), neveri ndaj ushqimit, vjellje, shtangimi i muskujve të qafës, etj.

Meningjiti bakterial

Një prej formave më të rënda të kësaj sëmundje që ka potencial të shkaktoj shpërthime epidemike



është pa dyshim ajo e shkaktuar nga meningokoku. Ky infeksion transmetohet nga njeriu i sëmurë tek ai i shëndoshë përmes spërklave dhe sekrecioneve të fytit dhe hundës. Qëndrimi i gjatë me pacientin është një lehtësim për transmetim të këtij infeksioni e sidomos kontakti i ngushtë me ta si p.sh. përqafim, teshtitje, kollitje, jeta në konvikte, etj.

Meningokoku pasi të shkaktoj infeksion të cipave të trurit jep këto shenja: temperaturë të lartë trupore, dhimbje koke e vazhdueshme, ngurtësimi i qafës, konfuzion mendor, ndjeshmëri e shtuar ndaj dritës dhe të vjella. Meningjiti i shkaktuar nga meningokoku jep një shenjë karakteristike që është shfaqja e petekieve, që janë njolla me ngjyrë të kuqërremtë që paraqiten në lëkurë dhe nuk iu humb ngjyra edhe pas presionit me ndonjë mjet të fortë të tejdukshëm (p.sh. qelqi).

Meningjiti tuberkular

Zakonisht inflamacioni te këto meningjite ndodh në mënyrë dytësore (nga vatra pulmonare e tuberkulozit), si pasojë e përhapjes së bacilit nga vatra pulmonare me rrugë limfohematogjene (me limf dhe gjak). Ky lloj i meningjiteve vihet re në vendet që ka një sëmundshmëri të lartë të tuberkulozit.

Ka fillim të menjëhershëm dhe zhvillim të shpejtë të karakterizuar me kriza convulsive, dhimbje koke, të vjellura, shtangim i muskujve të qafës, si dhe fortësim të muskujve të barkut, temperaturë e shoqëruar me djersë, etj.




Statistikat në Kosovë


Derisa vendet përreth nesh tani më janë duke alarmuar për një epidemi të meningjtit, mantelbardhët e Kosovës ende nuk e shohin të rrezikuar vendin nga kjo sëmundje.

Në vitin 2006 në QKUK gjegjësisht në klinikës infektive ka pasur gjithsejtë 1107 të sëmurë nga meningjiti prej të cilëve 731 kanë qenë meshkuj dhe 376 femra. Në vitin 2007 ka pasur gjithsejtë 751 raste, prej të cilëve 488 meshkuj dhe 263 femra.

Statistikat e të sëmuarve me meningjit në vitin 2006



Statistikat e të sëmuarve me meningjit në vitin 2007




Gripi favorizon meningjtin

Koha që tani jemi është favorizuese e paraqitjes së epidemive gripoze dhe në qendrat ambulatorore si dhe në qendrat e mjekësisë familjare tanimë kemi një turmë njerëzish me sëmundjen e gripit. Nga kjo që u tha, vlen të theksohet se sipas specialistëve gripi mund ta favorizoj paraqitjen e sëmundjes së meningjtit.

Nuk preferohet vaksinim kolektiv

Sipas epidemiologëve tek personat që ndodhën në kontakt me rastet sporadike të shfaqura të meningjtit, vaksinimi ndaj shkaktarit siç është neiseria meningitidis (meningokoku) nuk preferohet ngase sipas tyre është më mirë të ndiqet sëmundja nëpërmjet profilaksisë të personat e afërt me të sëmurin. ■

Fjalëkryqi

Autor : ENDRITI	SHTET ME I RI NE BOTE	FSHATI I LINDJES SE KOMANDANT ISMET JAS- HARI UÇK	KËNGE DJEPI	▼	SHPEND I EGËR SHTET NE AZI						PAQJA	MËVETËSI POLITIKE	AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSELINI	EMËR MASH- KULLI GJER- MAN	GURRAT	TITANI, AZOTI	
BUJUTINË	○										KUSAR						
BIMË BARISHTORE NJËVËJEÇARE E VENDEVE TË NGROHTA (shq.)	○										KIK-BOKSERI SHQIPTAR MAKSUTAJ (shq.)						
KËNGËTARI HOXHA	○										ATDHE (krah.)						
→	○					KODI I TELE- FONIT MOBIL					KRYEMURG					XEHETAR (sh.shq.)	
KËNGËTARJA RADI FUTBOLLISTI HOLANDEZ RUD ... NISTELLROJ	○										QYTET NE FRANCË				SHKRONJA E 18-të KËNGËTARJA ADELINA		
ZEZAKE	○										SHKRONJA E 8-të dhe e 17-të			3.14 SHKRIMTARJA SHQIPTARE XHUNGA			
PAQJA	KOMPOZITORI PRESHEVA KOMANDANTI LEGJENDAR I UÇK-së					FILMI I PARË SHQIP	HEROI KRYESOR NE ILIADËN E HOMERIT	KUPONI, TRISKA	↓	HEROI PASHKO "KENIA"	EAST	LLOJ HELMI					
ZANORE	○	KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE EMËR YNI MASHKULLI (shq.)										ISLANDA POLITIKANI SHQIPTAR SHEHU (shq.)	GODINA MBI UJË ZANORE				
DRITËRO AGOLLI	○		BASHKËVEN- DASE E ODI- SEUT E FUTA NE UJËRA								SHKRONJA E 28-të STUDIM I HOLLËSISHËM (sh.shq.)	ZAKON ORË E ÇAST, GJITHNJË					
KUNDREJT E VJETËR	○			Këngëtarja Klirani Ligji që i është shtuar ndonjë anëks, ligji						ERBIUM, FOSFOR, SHKOJ, ECI			POLITIKANI KROAT SANADER				
LEGJENDA	○				THIRRJE NE TELEFON NORA ISTREFI				AKTORI YNE REXHEPI PËRMENËR VETOR				SHEGË ELEMENT KIMIK				
SHOK	○					I PËRZIEVA KUVENDI I KOSOVES									ZANORE GJENDJE E PA PUSHTET		
I PAGJAK	○						NDERIMI QË I BËHET MYSAFIRIT (arab.) BISKOTAT E GATUARA ME ARRA							ALI TEPE- LENA KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)			
JEPA DIÇKA ME PARA	○				DEM, TER FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (shq.)			ASCOLI KORÇA, MIT- ROVICA		EMANK I EMRIT ONELANA MËNYRË E TË VESHURIT						SHETET FEDERAL NE SHBA	
→	○					MITRUSH KUTELI NIKELI, REO- MIRI			SHTET NE AZI ... LANKA INDIUM				I PARI I XHAMISË (pashq.) PJËSËTARE E NJË ORGA- NIZATE				
USHTARAKU SHQIPTAR HALLI ... RENO IDOR	○		LLOJ EKS- PLOZIVI (shq.) I GJYMT									TË FTOHTIT E MADH EMËR YNI MASHKULLI					
ISTRES	○	EMËR YNI MASHKULLI KILOGRAMET (krah.)							KËNGËTARI MUSHKOLAJ PJE QË TË FORCON E TË JEP FUQI				NORTHERN KARATE SCHOOLS QË KA TË BËJË ME FSHATIN				
PAQJA	VEND I HAPUR NE MURIN E NJË SHTËPIE (sh.shq.) QË NJË I PËRKËT FESE								SËMUNDJE E RËNDE NGJITËSE KËNGËTARJA AMËRIKANE TARNER						SHKRONJA TË NJËJTA TAGRETA (shk.)		
LLOJ PUJE ALKOOLIKE						"O" në mes të dy "T"				TATUAZHET MORGAN (perkdh.)						SUDANI ... DE ZHA- NIERO	
FUTBOLLISTI ANGLEZ SMITH (shq. - orgj.)						MBAJTJE E ANËS NJË EKIPI SIRIA, RUANDA					SHERRI, DEMI RIFAT AVDIU						
ION EXCHAN- GE TUMOR TARGETING					QË KA TË BËJË ME STINËN ZANORE							EMËR YNI MASHKULLI SHKRONJA E 16-të					
KËSHILLI TRANZITOR			PAQJA	→				LLOJ SHE- QERKE						DY ZANORE			